

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7681 E martë 16 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Ekemi fjalën për përkthimin si profesion dhe mjeshteri e spikatur, por edhe pjesë përbërëse e historisë, artit, kulturës, diplomacisë, drejtësisë dhe ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Përkthimi si art, mjeshteri dhe pasion



Opinion **i** Ditës

Kryeministri mbledhi sot të gjithë shefat e policisë për t'i përdorur si dekor në mesazhin që kërkoi t'i jepte publikut: se ndryshe nga perceptimi, statistikat ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI

Perceptimi për krimin/ Ramës i është thyer termometri



"Duhet 10 vjet përvojë në specialitet"
Garë për drejtues të 41 shërbimeve në QSUT, ministria: Kriteret e aplikimit

"Krerët" e pavioneve në spitale, deri në 5 nëntor duhet dorëzuar dokumentacioni
VOLTIZA DURO
Deri në 5 nëntor, të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të fitojnë një pozicion si drejtues shërbimi në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" mund të aplikojnë duke dorëzuar dokumentacionin përkatës ...
Në faqen 10

SKANDAL NE KOMITETIN E STABILIZIM-ASOCIIMIT, "MOLLA E SHERRIT" TAULANT BALLA PS-PD, SHERR NE BRUKSEL. BE: ZGJIDHENI NE TIRANE

Genc Pollo: Të zëvendësohet Balla, është mik i trafikantit. Fleckenstein: Unë nuk jam polic, shkoni në prokurori. Spiropali: Opozita u turpërua



(Në foto) Komiteti i stabilizim-asocimit

OPOZITA
Basha: Hetim për Ramën e Xhafajn. Kryemadhi: Revolta, është e vetmja rrugë
Në faqen 4

HISTORIA E KRIMIT
Vrau tre vetë në Mat, autori në gjykatë: Vendosni si të jetë ligji
Në faqen 6

FLET AKTORJA
Suela Bako: Në jetë kanë sukses ata persona që dëgjojnë veten
Në faqen 12-13

INTERVISTA
'Përgjimi me Agron Xhafajn', Babalja: 100% i vërtetë, Alizoti i droguar
Në faqen 11

RISITE NE FAKULTETE



"Luarasi" nis vitin akademik, ceremoni pritëse për studentët
Në faqen 9

Ekskluzive/ Raporti i 1973, ku sekretari i parë i Mirditës, Jovan Bardhi informon Komitetin Qëndror

"E kritikoi Enveri, pse e botoi 'ZP' Xhevahir Spahiun?"

Denoncimi: Në revistën "Shqiptarja e Re", botohen modele të modës së huaj

Nga DASHNOR KALOÇI
Ai lloj liberalizmi që u vu në Arë, apo u lejua po themi nga regjimi komunist Tiranës në fundin e viteve '60-të dhe fillimin e viteve '70-të, gjë e cila preku pothuaj të gjithë jetën e vendit dhe normalisht edhe artin, kulturën dhe letërsinë,



ndaloi si me komandë në janarin e vitit 1973, kur Enver Hoxha hodhi kritikën e para ndaj Festivalit të 11 Kombëtar të Këngës në Radio Televizion. Ky festival për të cilin mund të thuhet se ishte dhe "maja" e liberalizmit në jetën artistike e kulturore të vendit ...
Në faqen 16-17

DEBATI NË BRUKSEL

PS-PD

Opozita dorëzon memorandume sqaruese në Komitetin e Stabilizim Asociimit

Genc Pollo: Eurodeputetët po kërkojnë sqarime nga qeveria për lidhjet me krimin

"Shumë shpejt çështja do të sqarohet në gjykatë"

Përfaqësuesit e opozitës dorëzuan memorandume sqaruese në Komisionin e Përbashkët të Stabilizim Asociimit. Në një deklaratë pas mbledhjes së përbashkët, nënkryetar i delegacionit shqiptar, deputeti demokrat Genc Pollo u shpreh se "në mbledhjen e Komisionit të Përbashkët të Stabilizim Asociimit shpjeguan gojarisht e dorëzuan memorandume sqaruese se është tallje me dinjitetin e njeriut dhe dinjitetin e ligjit të diskutojmë për luftën kundër krimit, drogës e korrupsionit e të miratojmë deklarata ndërkohë që mbledhjen e (bashkë) kryeson Taulant Balla. Mendoj se edhe shumë deputetë normal të mazhorancës dhe i gjithë opinioni publik bie dakord për sa më lart". "Bien dakord edhe shumë eurodeputetë të informuar, pavarësisht se ata ruajnë aparencat dhe thonë me të drejtë se kjo çështje duhet zgjidhur në Tiranë. Por Rama e Ruci nuk deshen të pranojnë një zgjidhje të thjeshtë që u propozuam para një jave. Të emëronin një socialist normal (ka ende të tillë) në krye të delegacionit parlamentar. Pse nuk e bënë e dinë ata", u shpreh deputeti Pollo. Duket se demokratët kanë ndër mend që për të zgjidhur këtë të shfrytëzojnë edhe gjykatën. "Ndonjë deputet thotë se kjo çështje sqarohet në gjykatë. E drejtë edhe kjo. Aty do të sqarohet në një ditë jo të largët. Por për he prokuroria e gjykatat janë me probleme e nuk para merret me skandalet e qeverisë. Pastaj politika është për të vepruar shpejt kur ka bazë e jo me vite. Dhe Balla i ka pranuar një pjesë të fajësimeve", tha më tej, Pollo. Sipas tij, "eurodeputetët kërkojnë sqarime nga ekzekutivi i tyre për raste Bego, Beço, Rraja etj. Interesante të ndjekim zhvillimet.

Eurodeputetët mund të mos kenë mekanizëm procedural për ta larguar Ballën.

Por, siç e thanë, do zënë hunden me dorë e vazhdojnë një orë punë. Por të mos presim nga Parlamenti Europian të na zgjidhi problemet një më një. Balla është problemi i rëndësishëm i Rilindistave. Aty ku

lindi aty duhet zgjidhur: në Shqipëri!", theksoi Pollo. Sipas tij, memorandumet e opozitës do të bëhen publike nga BE në ditët në vijim. Gjatë kohës së bojkotit të mbledhjes së përbashkët,

Pollo foli për mediat në Shqipëri. "Edi Rama nguli këmbë, ndoshta më shumë nga halli sesa nga qejfi, që Taulant Balla të mbetet fytyra parlamentare e Shqipërisë kundrejt Parlamentit Europian e Bashkimit Europian. Kjo është mënyra më efektive për të diskredituar Shqipërinë para Europës mbasi i mbushën radhët e deputetëve e kryebashkiakëve socialistë me soj e sorollop banditësh. Pse duhet që i pari i delegacionit parlamentar në Bruksel të jetë boçe e brekushe me begot, beçot, rrajot e të tjerë si ata. Apo tani që na doli ministri për Europën në biseda me bandat kush pyet për Taulant", u shpreh Pollo. Sipas tij, "kjo është hera e fundit me Ballën bashkëkryetar në këtë parlament. Me Ballën shef delegacioni parlamentar sabotohet integritetin europian dhe hapja e negociatave vitin tjetër".



Deputeti demokrat Genc Pollo

Kreu i Grupit të LSI: Kemi të bëjmë me Rama-gate

Vasili: Audiopërgjimi për Agron Xhafaj tregoi se jemi para një grushti shteti

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petit Vasili akuzoi dje, sërish kryeministrin Edi Rama duke thënë se audio përgjimi ku shfaqet sipas tij vëllai i ministrit Fatmir Xhafaj në pazare droge zbuloi se shteti ndodhet në kushtet e një grushti të vërtetë shteti, në krye të të cilit është kryeministri. "Skandali i audiopërgjimit të vëllait të ministrit të Brendshëm zbuloi qartë se shteti ndodhet në kushtet e një grushti të vërtetë shteti, në krye të të cilit është kryeministri, pra jemi përpara një Rama-gate të vërtetë. Denoncimet e veprimtarisë krimi-



nale dhe përvijimit të trafiqeveve me mbështetje shtetërore janë shumë të qarta në publik dhe për këdo qytetar të thjeshtë. Por më e qartë se gjithçka është se kryeministri është autori dhe diriguesi i mbulimit

shtetëror, me çdo mjet dhe me çdo kusht të këtij skandali", u shpreh Vasili. Sipas tij, kryeministri në Shqipëri është investuar për mbulimin me çdo mjet për mbulimin e mashtrimit publik të ekspertizës së audiopërgjimit si dhe krijimin e të gjitha kushteve për largimin e errët dhe të rrufeshëm nga Shqipëria të vëllait të ministrit të Brendshëm". Duke përshkruar situatën e krijuar, Vasili tha se kemi të bëjmë me një Rama-gate në krye të një grushti shteti të trafikantëve dhe kriminelëve që nëpërmjet kryeministrit synojnë kapjen përfundimtare të shtetit.



Dje në mbledhjen e Komitetit ndërparlamentar të Stabilizim Asociimit mes Shqipërisë dhe Parlamentit Europian

Tabaku: Gjermania, hetim përfshirjes së Ballës në çështjen "Xhisiela"

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku u shpreh dje, se opozita e ka bërë të qartë qëndrimin e saj që nuk mund të bashkëjetojë me krimin. Ajo tha se vetë Balla e ka pranuar se ka një marrëdhënie të afërt me një person të lidhur me krimin, siç është Edmond Bego, i cili ka një dënim për trafik droge. "Ne kemi renditur të gjitha arsyet se pse nuk është e duhur që Taulant Balla të jetë bashkëkryetar komisioni. Ju mendoni se po të kishte pamje filmike që Taulant Balla nuk ka qenë në komisarjat, nuk do ishin bërë publike? Pala gjermane po heton për atë që po ndodh në Shqipëri. Ne nuk po kërkojmë këtu që zoti Balla të arrestohet, por ama shteti shqiptar nuk mund të përfaqësohet në nivele kaq të larta nga një figurë e tillë", u shpreh Tabaku, në një prononcim për Fax News nga Brukseli.



Basha në Bruksel në takimin e PPE për Ballkanin

Kreu i opozitës Luzvim Basha u nis drejt Brukselit për të marrë pjesë në samitin e Partive Popullore Evropiane, për Ballkanin Perëndimorë. Menjëherë pas kërkesës drejtuar prokurorisë për heqjen e imunitetit të Taulant Ballës dhe arrestimin e Ardi Velut dhe vartës të tij në policinë e Fierit, Basha do të takohet me liderët të partive të djathta evropiane, ndërsa në fokus të axhendës së tij do jetë situata politike dhe denoncimi i lidhjeve që qeveria ka me krimin e organizuar.





MONICA MAKOVEI

"Ne flasim për dialog politik, ku është? Pse të largohesh që në fillim, me një deklaratë të parapërgatitur? Ata erdhën në këtë takim në Bruksel me paratë e qytetarëve shqiptarë, për të ngrënë një drekë të mirë e për t'u larguar", -tha eurodeputetja Makovei.



FATE VELAJ

"Nëse opozita ishte kundër ardhjes së Taulant Ballës në EU parlament dhe përfaqësimit të tij si kryetar i komitetit AL-EU-AL, duhet të ishte ngritur e larguar kur Taulanti mori fjalën gjatë drekës dhe mbajti një fjalë plot mesazhe europiane. Apo, i kishte këputur uria dhe thanë, jemi që jemi, hamë pak se nuk i dihet darkës dhe e shtymë bojkotin për në sallë", -tha deputeti socialist.



Opozita bojkoton miratimin e deklaratës së përbashkët, shkon për drekë

PS-PD sherr në Bruksel, PD: Balla mik me kriminelë. Eurodeputetët: Provojini

Fleckenstein e Kukan-opozitës: Shkoni në prokurori

Socialistët dhe demokratët i transportuan dje, mosmarrëveshjet e tyre në Bruksel e pikërisht në mbledhjen e përbashkët të Komisionit Ndërparlamentar Shqipëri-BE. Sapo ka marrë fjalën Taulant Balla, në mbledhjen e Komitetit ndërparlamentar të Stabilizim-Asociimit mes Shqipërisë dhe Parlamentit European, demokratët e ndërprejnë duke kërkuar fjalën për procedurë. Pas një këmbënguljeje të gjatë, bashkëdrejtuesja tjetër e mbledhjes, Monika Makovei i dha Genc Pollos 30 sekonda kohë. "Ky takim bashkëdrejtohet nga një mik i ngushtë, siç e ka pranuar ai vetë, i një trafikanti të njohur droge, i dënuar në Itali me 22 vite burg. Ky bashkëdrejtues është Taulant Balla. Është turp që kryeministri ynë nuk e zëvendësoi atë me një tjetër deputet socialist normal, siç kërkuam javën e kaluar", tha Genc Pollo. Me mbarimin e kohës, mikrofonin i Pollos u fik, por kolegja e tij demokratke Albana Vokshi, që i ishte ulur në krah, kishte gati celularin për ta filmuar. "Do të ishte një maskaradë, një tallje për komitetin tonë, nëse ne adoptojmë rekomandime duke bërë apel për luftën ndaj krimit, narkotikëve dhe korrupsionit, me Ballën që drejton takimin. Unë nuk dua të jem pjesë e kësaj maskarade e talljeje, ndaj do të largohem dhe nuk mund të kthehem, për sa kohë Balla qëndron në krye të panelit. U bëj apel kolegëve të mi të bëjnë të njëjtën gjë", tha më tej Pollo. Pas kësaj, deputetët opozitarë të delegacionit shqiptar braktisën mbledhjen. Por pas kësaj deklarate reagoi eurodeputetja, bashkëdrejtuese e tryezës, Monica Makovei:



ELISA SPIROPALI

Deputetja socialiste, Elisa Spiropali, përfaqësuese e delegacionit shqiptar në Komitetin e Stabilizim-Asociimit, BE-Shqipëri, tha se opozita u turpërua në sytë e europarlamentarëve. Spiropali tha se opozita nuk ka kërkuar përjashtimin e Ballës nga delegacioni, por ka hedhur akuza dhe baltosje kundër vendit.

EDUARD SHALSI

"Ishte e shëmtuar dhe turpshme ajo që ndodhi. Nuk ishte bojkot, por ishte një largim i befëhtë që "shastisi" edhe deputetët e PE. Nuk janë deputetë të majtë, por ka edhe të majtë dhe të djathtë që u befusuan nga sjellja aspak e denjë e opozitës shqiptare. Janë skena që i kemi parë në parlamentin shqiptar dhe shpresonim se do t'ia kursenin deputetëve europiane", -tha për ngjarjen e djeshme Shalsi.

Komiteti BE-Shqipëri miraton deklaratën e përbashkët

Balla: PE mbështet hapjen e negociatave në qershor 2019

Parlamenti European ka miratuar deklaratën Përfundimtare të Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri. Kështu u shpreh Taulant Balla në një status në rrjetet sociale pas diskutimeve disa orë në PE. Ai thotë se Brukseli shpreh mbështetjen e plotë për hapjen e negociatave të Shqipërisë në qershor të 2019. "Faleminderit Parlamentit European grupeve më të mëdha politike nga e djathta në të majtë, për miratimin e Deklaratës Përfundimtare të Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, e cila fillon me këtë fjalë: Rishprehim mbështetjen e plotë për hapjen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin European në qershor 2019. Jam krenar që



Shqipëria ka këtë mbështetje kaq të madhe në PE", theksoi Balla. E në një shënim në fund të postimit, Balla u shpreh: "Jam i

keqardhur për teatrin e radhës së opozitës edhe këtu, ku duhet të jemi të gjithë bashkë për Shqipërinë që Duam". Më herët ai i

ANETARESIMI

"Faleminderit Parlamentit European grupeve më të mëdha politike nga e djathta në të majtë, për miratimin e Deklaratës Përfundimtare të Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, e cila fillon me këtë fjalë: Rishprehim mbështetjen e plotë për hapjen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin European në qershor 2019.

Nuk është se ne nuk ju besojmë juve, por ne nuk na lejohet t'iu besojmë juve, nëse ju nuk ndiqni procedurën normale", -tha Fleckenstein. As europarlamentari Kukan, që i përket spektrit të djathtë, nuk u doli në mbrojtje demokratëve. "Ata paraqitën akuza shumë serioze, por këto çështje duhen zgjidhur në Shqipëri, në parlamentin

shqiptar dhe jo në Parlamentin European", tha Kukan. Si bashkëdrejtues i mbledhjes për palën shqiptare, Taulant Balla tha se gjithçka ishte urdhëruar nga Lulzim Basha. "Duket këtu sikur ju e doni vendin tim më shumë sesa opozita ime. Nëse një e një milionta e atyre që tha z. Pollo është e vërtetë, jam gati të procedohem para Parlamentit

European, në sheshin e Luksemburgut. Fatkeqësisht, kolegët e mi nga opozita më thanë se ishin urdhëruar nga z. Basha për të bërë këtë teatër. Kolegët demokratë duhet të kuptojnë se në pushtet vihet vetëm përmes zgjedhjeve", tha Balla. Me largimin e opozitës, deklarata përfundimtare me rekomandimet e përbashkëta nuk arriti të kishte unanim-

itet, por mori mbështetjen bipartizante të PE-së për hapjen e negociatave të anëtarësimit qershorin e ardhshëm mes Shqipërisë dhe BE-së. Sipas Taulant Ballës në këtë deklaratë shprehet mbështetja e PE-së për Shqipërisë. Pas debateve në mbledhje, opozita u bashkua drekës, ku deputetët e PD-së dhe të PS-së qëndruan pranë njëri-tjetrit.

**KRIMI
REAGIMET**

"Babalja", kreu i PD-së paralajmëron prokurorët e policët: Do mbani përgjegjësi

Basha, prokurorisë: Balla të merret i pandehur, hetim edhe për Ramën e Xhafajn

"Socialistët të distancohen nga regjimi kriminal i Ramës"

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha i kërkoi prokurorisë që të nisë hetimet për Taulant Ballën. Sipas Bashës, "faktet për inkriminimin e Taulant Ballës dhe Ardi Velit për të krijuar dhe paguar një dëshmitar të rremë me qëllim mbrojtjen e trafikantit të drogës Agron Xhafaj, vëllait të ministrit të Brendshëm, janë të pakundërshtueshme". "Patkeqësisht deri tani nuk ka filluar ende asnjë hetim për Taulant Ballën. Nuk ka filluar asnjë hetim për Ardi Velin.

Nuk ka filluar asnjë hetim për drejtorin e policisë së Fierit, Manipulimi i hetimeve dhe mos-hetimi i krimeve nga prokuroria, janë krime të rënda për të cilat dyshja Marku-Prela dhe shërbëtorët e saj në prokurori do të mbajnë përgjegjësi", u shpreh dje, Basha në një dalje për mediat. Ai paralajmëroi se "shërbimi i verbër ndaj Edi Ramës është shërbimi ndaj kimit dhe për këtë do mbajë përgjegjësi çdo polici, çdo prokuror, çdo punonjësi i shtetit. Ata që mendojnë se mund të bëjnë krime se do t'i mbrojtë Edi Rama e kanë gabim. Pushteti i Edi Ramës ka marrë fund - rrëzimin e këtij pushteti nuk e ndal më asgjë". "Ju bëj thirrje prokurorëve të ndershëm që t'i rezistojnë urdhrave të paligjshëm dhe arbitrare të Arta Markut dhe Donika Prelës që janë vënë në shërbim të Edi Ramës dhe kimit për të shkatërruar hetimet dhe provat", u shpreh Basha. Po ashtu ai i drejtua prokurorëve: "Ju bëj thirrje burrave dhe grave me kurajë në prokurori, që në zbatim të ligjit dhe në kundërshtim të urdhrave kriminalë e të paligjshëm, të nxjerrin menjëherë fletarrestet për Ardi Velin dhe drejtorin e policisë së Fierit, të nisin menjëherë pa humbur kohë procedurën e heqjes së imunitetit dhe marrjes së pandehur të Taulant Ballës, dhe të nisin hetimin për pengim të drejtësisë ndaj Edi Ramës, Fatmir Xhafajt dhe Donika Prelës". Kreu i PD-së tha se provat janë të qarta dhe ulëritëse, dhe nga vetë fashikujt zyrtarë të përgjimit të prokurorisë del zbuluar se si kupola e policisë dhe e prokurorisë, me përfshirjen e Taulant Ballës dhe nën mbrojtjen e Edi Ramës dhe Fatmir Xhafajt ka gjetur, manipuluar dhe paguar një dëshmitar të rremë për të shpëtuar narkotrafikantin Agron Geron Xhafaj, vëllain e ministrit të Brendshëm.

Ai u bëri thirrje policëve të ndershëm të mos rreshtohen përpara kryeministrit me kokën ulur duke gëlltitur



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha

se si ai shan. Por u bën thirrje edhe socialistëve të ndershëm "që të distancohen nga regjimi kriminal i Edi Ramës. Jo vetëm si socialistë, por edhe si qytetarë, ata nuk duhet ta lejojnë partinë e tyre të kthehet në një organizatë kriminale të marrë peng nga njerëz pa

asnjë moral dhe pa asnjë ideal shoqëror dhe njerëzor, një organizatë kriminale e cila sot ka marrë peng shtetin dhe drejtësinë". "Partia Demokratike dhe opozita nuk do tërhiqen asnjë çast dhe para asnjë gjëje nga beteja jonë jetike për çlirimin e politikës, ekonomisë dhe

shoqërisë nga krimi. Beteja e nisur do shkojë deri në fund. E di që shumë prej ju duan zgjidhje të menjëherëshme, por dua t'i siguroj sot se fitorja ndaj kimit dhe pushtetit mafioz të Edi Ramës është e pashmangshme dhe e afërt", theksoi Basha.

TAULANT BALLA

"Lulzim! Ti e di që je zyrtarisht në hetim për "kallëzimet të rremë" bashkë me Shpifës Nuhun. Për mua flasin qartë kamerat e komisarariatit (s'kam qenë hiç aty, madje as Nuhun s'e ke aty). Nesër, sapo të kthehem nga Parlamenti Europian, gati një kallëzim ijtë për ty dhe Florenc Hoxhën, shokun tënd të famshëm që s'i zë dora vend pa shkelur ligjin", - tha dje, Balla, pas deklarimit të së Bashës.



Gjatë një seance parlamentare

SHPIFJA



Deputeti i PD-së Salianji ironi me Ballën: A ndryshohet sistemi TIMS me fotoshop?

Deputeti i PD, Ervin Salianji ka ironizuar kreun e grupit parlamentar të PS, Taulant Balla pas padisë së këtij të fundit për shpifje në lidhje me akuzat se deputeti socialist ka udhëtuar 57 herë jashtë vendit me Edmond Begon për të cilin opozita thotë se është trafikant droge dhe i dënuar në Itali me 21 vite burg. "Duke u përgatitur për një gjykatë. A mund të ndryshohet sistemi TIMS me fotoshop?" - ka shkruar Salianji në 'Facebook' duke publikuar edhe udhëtimet dhe destinacionet që ka kryer sipas tij Balla me Begon. Pas dorëzimit të padisë në gjykatë ditën e diel Taulant Balla tha se çdo shpifje nga 'aktorët e SHQUP-it' do të përfundojnë në gjykatë, ndërsa dëmshpërblimet nga gjyqi do shkojnë për Fondin e Edukimit, nismë kjo e shpalosur nga grupi i PS. Balla kërkoi 1 milion lekë të reja nga deputeti i PD-së, pasi sipas tij i ka shkakuar dëm moral.

VIZITA



Princi i Monakos sot në Shqipëri, Meta: Kemi marrëveshje të rëndësishme

Princi i Monakos Alberti II, do të pritet sot në një vizitë shtetërore dy ditore në Shqipëri. Në kuadër të kësaj vizite do të nënshkruhen dy marrëveshje të rëndësishme në lidhje me thellimin e bashkëpunimit ekonomik-financiar mes dy vendeve. Në njoftimin e Presidencës bëhet me dije se Lartësia e tij, Alberti II do të pritet me ceremoni shtetërore nga kreu i shtetit Ilir Meta për të vijuar më pas me bisedimet dypalësh midis dy delegacioneve respektive. Mësohet se gjatë vizitës së Princit të Monakos në Shqipëri pritet të nënshkruhen dy marrëveshje të rëndësishme, ajo e bashkëpunimit mes ministrave të Jashtme të dy vendeve dhe një marrëveshje financimi mes Fondacionit të Princit Albert II të Monakos dhe Administratës rajonale të Zonave të mbrojtura të Vlorës e Shokatës "Pisha Flamur" për mbrojtjen e burimeve natyrore.

Kryetarja e LSI-së: Opozita nuk bëhet alibi për vjedhjet e qeverisë

Monika Kryemadhi të rinjve: Revoltat, e vetmja mënyrë shpëtimi nga Rama

Gjatë një takimi me të rinjtë e LRI në njësinë numer 1 në kryeqytet, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi tha se rruga e vetme për largimin e kryeministrit Edi Rama është revolta. Kryemadhi tha se opozita nuk merr pjesë në punimet e Kuvendit, pasi sipas saj nuk mund të bëhet alibi e kriminelëve dhe vjedhjes së shqiptarëve. "Reforma që ne kemi votuar është e kapur nga Rama dhe i shërben bandave dhe viktimit janë qytetarët. Këto reforma që ne i shohim sot, janë kthyer në elementë që çdo ditë e më shumë po gllabërojnë shoqërinë shqiptare dhe po e kthejnë inekzistente. Pasi po t'u pyesësh, ju doni të ikni jashtë shtetit. Kjo është fatkeqësi për vendin, sepse në këtë drejtim ju shihni mundësinë për tu



larguar", u tha Kryemadhi të rinjve. "Sot kjo qeveri nuk të ofron siguri, barazi, ndershmëri dhe demokraci, nuk të lejon të thuash atë që mendon. Situata në të cilën na ka futur Edi Rama dhe Rilindja nuk ka më kthim mbrapa. Ka vetëm një mënyrë shpëtimi revolta. Të gjithë thonë se opozita duhet të shkojë në Kuvend, por për çfarë të shkojë opozita, të bëhet alibi për vjedhjet që po bëhen. Po më mirë të sh-

kojmë në shtëpi se të bëhemi alibi e këtyre kriminelëve", tha Kryemadhi, më tej. Ndërsa u ndal tek debati i zhvilluar në Parlamentin Europian, Kryemadhi tha se ishte normale kërkesa e opozitës, përderisa Taulant Balla nuk del i pastër nga akuzat që i bëhen për lidhje me krimin. "Sot opozita ka kërkuar që Taulant Balla të mos jetë bashkëkryetar i delegacionit, dhe është normale, përderisa nuk del i pastër nga akuzat për se ka qenë dëshmitarë i kërcënimit me armë të oficerit të policisë, përderisa nuk hedh poshtë lidhjen e tij me trafikantin Bego. Edi Rama mund ta zëvendësonte lehtë me Mimi Kodhelin apo deputetë të tjerë, por këtë nuk e bën, sepse është i lidhur me krimin", - theksoi Kryemadhi.

Enver Doçi

MAT

Jam i rënduar emociona lisht dhe nuk mund të flas. Vendosni si të jetë ligji". Vetëm këto fjalë ka thënë dje në sallën e gjyqit, Kujtim Koxha, i cili pasditen e së enjtes bëri masakër duke vrarë tre punonjësit e bashkisë së Matit dhe plagosur një tjetër: 51-vjeçari nga fshati Shëlli e njësisë administrative Lis, pothuajse gjatë gjithë seancës gjyqësore e ka mbajtur kokën ulur dhe ka heshtur. Pas paraqitjes së provave materiale nga prokurori i çështjes Abaz Muça, togat e zeza të Matit kanë vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj autorit të vrasjes së trefishtë që tronditi gjithë opinionin publik. Seanca gjyqësore është zhvilluar nën masa të rrepta sigurie, ndërsa 51-vjeçari është braktisur nga familjarët e tij. Gjithashtu, në seancë nuk kanë qenë të pranishëm as familjarët e tre viktimave. Ndërkohë, burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë me dije se pas ngjarjes së rëndë ku mbetën të vrarë shtetasit: Mentor Hoxha 36 vjeç, Erzen Aliaj 49 vjeç dhe Hamit Buçi si dhe mbeti i plagosur, Astrit Hani 40 vjeç, katër fëmijët e kryeplakut vrasës bashkë me vëllezërit e tij, kanë lënë fshatin Shëlli nga frika e gjakmarrjes. Të njëjtat burime pohuan se në banesën e 51-vjeçarit ndodhet vetëm bashkëshortja, e cila ruhet nga forca policore pas mbrojtjes që u vendos për këtë familje. Gjithashtu, mësohet se nga policia ruhet edhe vëllai tjetër i Kujtim Koxhës, i cili jeton në Mamurras.

GJYQI

Paraditen e djeshme u zhvillua seanca gjyqësore ndaj Kujtim Koxhës, i cili të enjten që shkoi vrau me breshëri kallashnikovi në lokalim e fshatit tre persona dhe plagosi një tjetër. Ai doli përpara gjykatës rreth orës 10:00, për t'u njohur me masën e sigurisë. I pyetur nga gjyqtari për avokatin mbrojtës, i pandehuri tha se do të përfaqësohej nga një avokat nga Tirana, të cilin ia kishin gjetur të afërmit, por ai nuk kishte ardhur. Koxha u përfaqësua nga një avokat i caktuar nga shteti. Ndërkaq, gjatë fjalës së tij, prokurori i çështjes Abaz Muça ka treguar dinamiken e ngjarjes si dhe ka paraqitur provat materiale të mbledhura në vendngjarje. Sipas prokurorit, vrasja e trefishtë ka ndodhur për motive të dobëta. Konkretisht të enjten, 51-vjeçari, kryeplak i fshatit ka debatuar me punonjësit e bashkisë që po punonin për rikonstruksionin e rrugës së fshatit. Përplasja ka nisur kush je ti dhe kush jam unë. Sipas përfaqësuesit të organit të akuzës, Koxha u ka thënë punonjësve: "Nuk do punoni më këtu për rrugën. Më jepni numrin e kryetarit të bashkisë". E ndërsa, ata kanë refuzuar t'i jepnin numrin e kryebashkiakut, Kujtim Koxha është nxehur me keq dhe i ka sharë. Sherri ka degjeneruar në fyerje e sharje të ndërsjella dhe më pas në vrasje.

Prokurori: Ja si nisi konflikti banal. Gjykata lë në burg autorin e vrasjes së trefishtë

Autori i masakrës në Mat, kokulur në gjykatë: Vendosni si të jetë ligji!

51-vjeçari Kujtim Koxha braktiset, familjarët largohen nga fshati nga frika e gjakmarrjes



51-vjeçari Kujtim Koxha, dje në gjykatën e Matit



Lokali ku ndodhi vrasja e trefishtë

FRIKA NGA GJAKMARRJA

Pas ngjarjes së rëndë ku mbetën të vrarë shtetasit: Mentor Hoxha 36 vjeç, Erzen Aliaj 49 vjeç dhe Hamit Buçi si dhe mbeti i plagosur, Astrit Hani 40 vjeç, katër fëmijët e kryeplakut vrasës bashkë me vëllezërit e tij, kanë lënë fshatin Shëlli nga frika e gjakmarrjes. Të njëjtat burime pohuan se në banesën e 51-vjeçarit ndodhet vetëm bashkëshortja, e cila ruhet nga forca policore pas mbrojtjes që u vendos për këtë familje. Gjithashtu, mësohet se nga policia ruhet edhe vëllai tjetër i Kujtim Koxhës, i cili jeton në Mamurras.

SI NISI KONFLIKTI

Sipas prokurorit, vrasja e trefishtë ka ndodhur për motive të dobëta. Konkretisht të enjten, 51-vjeçari, kryeplak i fshatit ka debatuar me punonjësit e bashkisë që po punonin për rikonstruksionin e rrugës së fshatit. Përplasja ka nisur kush je ti dhe kush jam unë. Sipas përfaqësuesit të organit të akuzës, Koxha u ka thënë punonjësve: "Nuk do punoni më këtu për rrugën. Më jepni numrin e kryetarit të bashkisë". E ndërsa, ata kanë refuzuar t'i jepnin numrin e kryebashkiakut, Kujtim Koxha është nxehur me keq dhe i ka sharë. Sherri ka degjeneruar në fyerje e sharje të ndërsjella dhe më pas në vrasje.



Shtyhen me 3 muaj hetimet për ish-ministrin Tahiri

TIRANË - Për të tretën herë janë shtyrë dje hetimet për ish-Ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Prokurorët e Krimeve të Rënda që e hetojnë kanë thënë se presin ende një letër porosi nga Bari, në Itali. Nga hetimet e kryera, ish-ministri Tahiri dyshohet se i ka krijuar lehtësira grupit të Habilajve për kultivimin dhe më pas trafikimin e kanabisit drejt Italisë. Këto dyshime, Prokuroria e Krimeve të Rënda i ka ngritur, pasi në më shumë se një rast ekspozantë të grupit kriminal kanë përdorur mjete motorike dhe detare në emër të ish-ministrin Tahiri. Prokuroria ka dyshime se Saimir Tahiri ka udhëtuar drejt Matit të Zi me persona, të cilët janë nën hetim në këtë dosje. Ndërsa nga Italia pritet që të mbërrijë dëshmia e Frederiko Silvestrit, person i cili dyshohet se i ka shitur një mjet lundrues grupit të "Habilajve". Vetëm pas mbërritjes së këtyre përgjigjeve prokuroria do të vendose nëse duhet ta dërgojë dosjen për gjykim.

"Patrulla e përgjithshme", dje përfundoi testi me shkrim për 2700 aplikantë

TIRANË - Rreth 2700 të rinj nga i gjithë vendi, janë bërë dje pjesë e konkursit për "Patrullë të përgjithshme" të Policisë së Shtetit, për 150 vende të lira. Testimi për të ndjekur studimet në Akademinë e Sigurisë u zhvillua në ambientet e Pallatit të Kongreseve. Ky është testi me shkrim që do të zhvillohet gjatë dy ditëve në vijim dhe që i paraprin testimit fizik dhe atij psikologjik. Ditën e sotme kandidatët u testuan mbi njohuritë e shkollës së mesme, ndërsa pjesët e tjera të konkurimit janë testimi fizik dhe ai psikologjik. Testimi me shkrim monitorohet me kamera edhe nga një grup i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nga SHÇBA, ICITAP e PAMECA. Në hapjen



e konkurimit, kandidatët i ka përshëndetur edhe Drejtori i Akademisë së Sigurisë, Bilbil Mema. Gjatë fjalës së tij Mema tha se nga kjo garë jo të gjithë do të dalin fitues. "Ju jeni të mrekullueshëm të gjithë, sepse me kërkesën tuaj doni të jepni kontributin për sigurinë publike në

Shqipëri, dhe kjo është shpresë shumë e madhe, garanci shumë e madhe për jetën tonë shoqërore, për familjet tuaja. Ju e bëtë këtë me vullnetin tuaj të lirë, që të vini të konkurroni, dhe një farë mënyre jeni të gjithë fitues, sepse jeni krenar që keni pranuar të vini të konkurroni për të dhënë kontributin tuaj në sigurinë publike. Natyrisht sot është një garë, jo të gjithë do të fitojnë, por ju e treguat veten tuaj. Këtu do të zgjidhen nga ju kolegët më të mirë, në një konkurim që ju do ta shikoni, do të jetë kreu i transparent, ku do të testohen njohuritë tuaja që keni marrë në shkollën e mesme, që janë të përgjithshme dhe mbi bazën e atyre, pastaj ju do të vazhdoni me karrierën tuaj në polici", tha Mema.

NJOFTIMI SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE "ILIA ELEZI"

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI "APARTAMENT", VOLUMI 6, FAQE 179, SIPERFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE B350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUM META DHE ZNJ. RITA META.

ÇMIMI 3.850.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë **09.11.2018** .

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

EPSA SHOQERIA PERMBARIMORE PRIVATE "E.P.S.A" SHIPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

1- "Ndërtesë 3 Kat", pa truall, me vetem Kati i Pare i regjistruar ne ZVRPPP Tirane me sip. 131 m² dhe Kati i Dytë dhe Kati i Tretë ndertim pa leje", i ndodhur ne Rr "Siri Kodra", Tirane, Zona Kadastrale: 8340, Numri i Pasurisë: 4/171-ND, Vol.9, Faqe 127. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te **Fethi Kaya**. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **12.320.000 Leke** . Ankandi zhvillohet **datë 23.10.2018 ora 16.00** në adresen Rr."1, Qemalli", Palli "Fratarri", K.6,Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

3H SHOQERIA PERMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k

Rr: "Tah Dahir", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Nr. 1, Tirane

Web: www.3h.al; Email: shqip_3h@shko.com; tel:0692099711

Njofton shpalljen e ankandit nga **dt.11.10.2018 deri ne dt. 19.10.2018** per: sendin e luajtshem mjeti me targe AA 089 OB ne pronesi te Subjektit Naber Konfeksion Shijak shpk me NIPT J62208504M

Çmimi fillestar eshte 993 EURO

Ankand i zhvillohet ne zyren permbarimore ne daten 19.10.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.

RAPORTI/ Shkelje e parregullsi të dispozitave ligjore në fushën e prokurimit publik

Abuzuan me detyrën, KLSH padit në prokurori ish-kryebashkiakun e Dibrës dhe 4 zyrtarë

I shkaktuan shtetit një dëm prej 72 milionë lekësh

TIRANË

Kontrolli i Lartë të Shtetit ka kallëzuar në prokurori ish-kryetarin dhe 4 drejtues të Bashkisë Dibrë, pasi akuzohen për shpërdorim detyre dhe shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tender apo ankande publike. Nga auditimi i KLSH-së, rezultoi se këta zyrtarë i kanë shkaktuar shtetit një dëm prej 71.8 milionë lekë ose mbi 570 mijë euro dhe efekt negativ në Buxhetin e Shtetit nga përdorimi i fondeve publike pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 204.2 milionë lekë ose mbi 1.6 milionë euro. Ish-kryetari i akuzuar nga KLSH-ja është Hetem Fida (përfaqësues i PDIU-së (prej një viti në pension). Gjatë auditimit, KLSH konstatoi shkelje dhe parregullsi të dispozitave ligjore në fushën e prokurimit publik, kryesisht në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, vlerësimin e ofertave ekonomike, duke vepruar me dy standarde vlerësimi, në zbatimin e investimeve etj.

RAPORTI I KLSH

Me Vendimin nr. 121, datë 06.09.2018 të kryetarit të KLSH-së, është miratuar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe me shkresën nr. 545/10, datë 06.09.2018, me qëllim përmirësimin e gjendjes i janë rekomanduar Bashkisë Dibrë masa me karakter organizativ, si dhe masa për shpërbllimin e dëmit ekonomik të shkaktuar në vlerën totale 71.8 milionë lekë (nga të cilat mbi 2.6 milionë lekë, në mos mbajtjen e penaliteve për punime jashtë afatit, 17.6 milionë lekë për mos aplikimin e TVSH-së në zbatimin e kontratave për punë publike dhe 51,552,315 lekë në përzgjedhjen e gabuar të ofertave fituese në procedurë të prokurimit), si dhe për përdorimin e fondeve publike pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 204.2 milionë lekë.

Gjatë auditimit, KLSH konstatoi shkelje dhe parregullsi të dispozitave ligjore në fushën e prokurimit publik, kryesisht në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, vlerësimin e ofertave ekonomike, duke vepruar me dy standarde vlerësimi, në zbatimin e investimeve, etj.

MË KONKRETSHT:

Në procedurën e prokurimit me objekt: "Përmirësim i infrastrukturës vendore dhe Rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës", për vlerën prej 173,490,908 lekë, në të cilën kanë marrë pjesë 1 operator ekonomik (OE) dhe 1 bashkim i operatorëve ekonomikë (BOE), është skualifikuar me të drejtë BOE për mungesë dokumentacioni dhe është kualifikuar OE që nuk plotëson këto kriter.

Në procedurën e prokurimit me objekt:

MASAT

Kontrolli i Lartë i Shtetit, me qëllim përmirësimin e situatës, i ka rekomanduar Bashkisë Dibrë masa me karakter organizativ në lidhje me eliminimin e praktikave që kanë sjellë impakt negativ në Buxhetin e Shtetit, kryesisht në fushën e tatim taksave, si dhe të ardhura të munguara në vlerën 30 milionë lekë.

"Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë", për vlerën prej 79,675,817 lekë, në të cilën kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomikë (5 prej tyre nuk kanë paraqitur oferta) dhe kanë paraqitur oferta 1 bashkim i operatorëve ekonomikë (BOE) dhe 1 operator ekonomik (OE), është skualifikuar me të drejtë BOE për mungesë dokumentacioni dhe është kualifikuar OE që ka mungesa të theksuara në dokumentacion.

Në procedurën e prokurimit me objekt: "Rinovimi i infrastrukturës së bulevardit "Elez Isufi", rrugës "Safet Zhulali" dhe rrugës së "Muzeut", për vlerën prej 92,272,248 lekë, në të cilën kanë marrë pjesë 2(dy) bashkime të operatorëve ekonomikë (BOE) dhe 5(pesë) operatorë ekonomikë (OE), janë skualifikuar me të drejtë 4 OE dhe 2 BOE për mungesë dokumentacioni dhe është shpallur fitues operatori ekonomik që rezultoi me mungesa të theksuara në dokumentacion.

Të tria procedurat e mësipërme të prokurimit të hapur, me fond limit me vlerën 345,438,973 lekë dhe oferta fituese në vlerën 339,269,335 lekë, me një diferencë më pak nga fondi limit (kursim) në vlerën 6,169,638 lekë, ose në masën 1.7%, i kanë shkaktuar një dëm ekonomik Buxhetit të Shtetit në të tri procedurat në shumën rreth 51.6 milionë lekë, si rezultat i diferencës ndërmjet vlerës së ofertës të operatorit ekonomik të kualifikuar padrejtësisht (me vlerë më të lartë) dhe vlerës së ofertës të operatorit ekonomik të skualifikuar padrejtësisht (me vlerë më të ulët), duke sjellë shpenzimin



- ZYRTARËT E DENONCUAR NGA KLSH**
- 1.H.F., me detyrë ish-kryetar i bashkisë Dibrë, në cilësinë e titullarit të Autoriteti Kontraktor.
 - 2.L.C., me detyrë drejtor finance, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave(KVO).
 - 3.K.S., me detyrë ish-përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Kujdesit Social, në cilësinë e anëtarit të KVO.
 - 4.K.R., me detyrë ish-përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, në cilësinë e anëtares së KVO.
 - 5.Z.G.J., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, në cilësinë e anëtares së KVO.

e më shumë fondeve buxhetore dhe shpallje fitues të operatorëve ekonomikë që nuk kanë plotësuar Dokumentent Standard të Tenderimit(DST).

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rinovimi i infrastrukturës së bulevardit "Elez Isufi", rrugës "Safet Zhulali" dhe rrugës së "Muzeut", Bashkia Dibrë, të kontratës me objekt "Sistemin asfaltim i rrugëve në lagje ku ka mbaruar njësjellësi", Bashkia Dibrë, të kontratës me objekt "Sistemin asfaltim rruga Borde - Peshkopi, Nj.A. Luzni", Bashkia Dibrë, të kontratës me objekt "Sistemin asfaltim

rruga Staravec-Shimçan-Zimur", Bashkia Dibrë dhe të kontratës me objekt "Ndërtimi i shkollës së mesme të përgjithshme Maqellarë", Bashkia Dibrë, rezultuan në total diferencë në vlerë pune të pakryera në fakt në vlerën 17.6 milionë lekë me TVSH.

Këto dhe shumë shkelje të tjera të konstatuara janë veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 "Për prokurimin publik", datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimi", pika 1, 2/a/b/c/dh, neni 2, "Parimet e përzgjedhjes", neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1

dhe neni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3; 5.

Për këto shkelje, KLSH, me shkresën nr. 545/11 datë 06.09.2018 ka depozituar kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibrë ndaj H.F., me detyrë ish Kryetar i Bashkisë Dibrë, në cilësinë e Titullarit të Autoriteti Kontraktor, L.C., me detyrë Drejtor Finance, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave(KVO), K.S., me detyrë ish-Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Kujdesit Social, në cilësinë e anëtarit të KVO, K.R., me detyrë ish-Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, në cilësinë e anëtares së KVO dhe Z.G.J., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, në cilësinë e anëtares së KVO, për konsumimin e elementëve të veprave penale "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tender apo ankande publike" dhe "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga nenet 258 dhe 248 të Kodit Penal. KLSH, me qëllim përmirësimin e situatës, i ka rekomanduar Bashkisë Dibrë masa me karakter organizativ në lidhje me eliminimin e praktikave që kanë sjellë impakt negativ në Buxhetin e Shtetit, kryesisht në fushën e tatim taksave, si dhe të ardhura të munguara në vlerën 30 milionë lekë.



Aksionet e policisë, në një javë u shoqëruan 414 persona

TIRANË - Policia e Shtetit dhe FNSh ka bërë bilancin e një jave në kuadër të masave për rritjen e parametereve të sigurisë dhe kapjen e personave në kërkim. Blutë bëjnë me dije se në operacionet e zhvilluara gjatë javës së kaluar, në të gjithë vendin janë sekuestruar arsenal armësh, lëndë narkotike si dhe janë shoqëruar për verifikim rreth 414 persona. "Në të gjithë vendin janë zhvilluar kontrolle nga FNSh e Policinë Vendore, janë ngritur e kanë funksionuar pika kontrolli dhe të lëvizshme, ku është bërë e mundur kapja dhe arrestimi i 211 personave, si dhe janë sekuestruar armë zjarri dhe lëndë narkotike. Nga Policia Rrugore në të gjithë vendin duke përdorur dragerat dhe radarët janë arrestuar në flagrancë për drejtim mjeti në gjendje të dehur apo pa leje drejtimi 58 drejtues mjetesh. Nga kontrollet e kryera nga strukturat e Drejtorive Vendore të Policisë janë kapur 47 persona në kërkim kombëtar/ndërkombëtar", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë.

STRATI Shoqëria përbimbarime "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Apartment nr. 37", me sipërfaqe 69.7 m², i ndodhur në katin e pestë, seksioni i dytë të godinës 8 katëshe, në Linzë, Komuna Dajt, Tiranë, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 2099, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale 2460, regjistruar në pronësi të EuroVini sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 27,880 Euro.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 24.10.2018;

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbimbarime "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

STRATI Shoqëria përbimbarime "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

-Regjistruar në Regjistrin hipotekor me Nr. 2035, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale me Nr. 2460, Apartament (3+1), Nr. 22, me sipërfaqe 136 m², Seksioni Nr. 1, ndodhur në katin e katërt të Godinës së banimit dhe shërbimit 4-7-8 katëshe plus një kat parkim, Linzë, Komuna Dajt, Tiranë, regjistruar në pronësi të Shoqërisë "Eurovini" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 52,584 Euro.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 26.10.2018.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbimbarime "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Takimi i FMN-së dhe Bankës Botërore, çfarë premtoi guvernatori

Sejko: Ulen kreditë e këqija, tregues pozitiv

"Aktiviteti ekonomik ka vijuar të shënojë përmirësim"

Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të japë të gjithë mbështetjen e duhur nëpërmjet vazhdim të stimulit monetar, me synim nxitjen e aktivitetit ekonomik dhe kthimin e inflacionit në objektiv", - tha guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, i cili mori pjesë në mbledhjet vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të grupit të Bankës Botërore, që u zhvilluan në Bali, Indonezi. Gjatë pjesëmarrjes në këto mbledhje, guvernatori Sejko zhvilloi disa takime të rëndësishme me personalitete të njohura të fushës financiare ndërkombëtare. Gjatë takimeve, ai bëri një ekspozitë të situatës ekonomike dhe financiare shqiptare, duke theksuar se aktiviteti ekonomik në vend ka vijuar të shënojë përmirësim dhe shprehur angazhimin e Bankës së Shqipërisë për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë. Për sa i përket sistemit bankar, guvernatori u shpreh se ai shfaqet me tregues mjaft të mirë financiarë, i mirëkapitalizuar dhe likuid. Rënia e

GUVERNATORI

Sistemit bankar shfaqet me tregues mjaft të mirë financiarë, i mirëkapitalizuar dhe likuid. Rënia e mëtejshme e treguesit të kredive me probleme në nivelin 12.9%, më i ulëti në këto vitet e fundit, është një shenjë pozitive, që i hap rrugë rritjes së pranisë dhe kontributit të sistemit bankar në ekonomi.



Banka e Shqipërisë

mëtejshme e treguesit të kredive me probleme në nivelin 12.9%, më i ulëti në këto vitet e fundit, është një shenjë

pozitive, që i hap rrugë rritjes së pranisë dhe kontributit të sistemit bankar në ekonomi. Më tej, guver-

natori Sejko theksoi se sistemi bankar është aktualisht nën një proces konsolidimi dhe siguroi përfaqë-

suesit e FMN-së dhe BB-së se Banka e Shqipërisë do të ushtrojë me përpikmëri dhe rreptësi rolin e saj rregulla-

STABILITETIN FINANCIAR

Banka e Shqipërisë do të ushtrojë me përpikmëri dhe rreptësi rolin e saj rregullator dhe mbikëqyrës, duke garantuar që aktorët e rinj në treg të përbushin plotësisht kërkesat ligjore, e duke ruajtur të pacenueshëm stabilitetin financiar të vendit.

tor dhe mbikëqyrës, duke garantuar që aktorët e rinj në treg të përbushin plotësisht kërkesat ligjore, e duke ruajtur të pacenueshëm stabilitetin financiar të vendit. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e FMN-së dhe BB-së vlerësuan pozitivisht rolin dhe politikën e ndjekur nga Banka e Shqipërisë, e cila ka kontribuar në zhvillimin dhe stabilitetin makroekonomik të vendit. Në veçanti, mbajtja e një kursi akomodues të politikës monetare, ndërhyrjet në tregun valutor me qëllim ruajtjen e objektivit të inflacionit, si dhe kujdesi i vazhdueshëm i treguar në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar u cilësuan si veprime mjaft të nevojshme dhe të përshtatshme.

Qeveria shqiptare do të ndalojë importin e automjeteve të prodhuara para 10 vitesh, por ekspertët thonë se ai duhet të shoqërohet me një paketë lehtësuese, për të mos penalizuar ato familje që duan të blejnë një makinë. Referuar "Scan TV", ekspertët janë skeptikë edhe për efektet që zbatimi i këtij vendimi do të sjellë reduktimin e ndotjes, pasi janë shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në këtë drejtim. Kufizimi i importit të makinave të vjetra pritet të ketë efekte negative për të gjitha bizneset që operojnë në këtë treg, ndërkohë që të privilegjuarit do të jenë koncesionarët, që do të rrisin shitjet e tyre. Ndryshimet që do të pësojë tregu i automjeteve diskutohen edhe nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas së cilës për vitin 2017 dhe 2 muajt e parë të vitit 2018, rreth 81% e automjeteve të regjistruara në vendin tonë janë të prodhuara para vitit 2009, ndërkohë që vetëm 19% e tyre janë prodhuar në 10 vitet e fundit. Ndërkaq, ndotja e ajrit ka sjellë rritje të sëmundshmërisë të popullata. Sipas mjekëve, grimcat e pluhurit për shkak të diametrit të tyre më pak se 10 dhe 2,5 mikronë depërtojnë thellë në rrugët e frymëmarrjes, madje deri në gjak. Një pjesë e madhe e këtyre grimcave solide thithen nga pjesa e rrugëve

Shtuan ndotjen e ajrit, rritet numri i të sëmurëve me kancer

Ndalimi i importit për makina të vjetra, ekspertët: Paketë lehtësuese



të sipërme aspiratore, ato më të voglat kalojnë në rrugët bronkiale dhe një pjesë e tyre kalon edhe në gjak. Ndotja e ajrit është një nga faktorët riskantë për shfaqjen e kancerit të mushkërisë. Ndotja e ajrit mund të jetë faktor risku për zhvillimin e disa sëmundjeve të caktuara të rrugëve të frymëmarrjes, por edhe si shkak për krye-

sor dhe gjithashtu, edhe faktor i veçantë i acarimit të këtyre sëmundjeve", shprehet mjekja pneumologe, Olvis Petre. Vetëm dy vitet e fundit, në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi" ka një rritje me 25% të kancerit të mushkërisë, ndërsa asma bronkiale është 20% dhe 6.8% sëmundjet pulmonare obstruktive kronike.

IMPORTI

Kufizimi i importit të makinave të vjetra pritet të ketë efekte negative për të gjitha bizneset që operojnë në këtë treg, ndërkohë që të privilegjuarit do të jenë koncesionarët, që do të rrisin shitjet e tyre.



NDOTJA E AJRIT

Ndotja e ajrit ka sjellë rritje të sëmundshmërisë të popullata. Sipas mjekëve, grimcat e pluhurit për shkak të diametrit të tyre më pak se 10 dhe 2,5 mikronë depërtojnë thellë në rrugët e frymëmarrjes, madje deri në gjak. Një pjesë e madhe e këtyre grimcave solide thithen nga pjesa e rrugëve të sipërme aspiratore, ato më të voglat kalojnë në rrugët bronkiale dhe një pjesë e tyre kalon edhe në gjak.

NJOFTIM

Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k. propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORÇA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajtitit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e licensuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjjes Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Në vijim, do të informoheni për vendin dhe datën e saktë të zhvillimit të dëgjjes, nëpërmjet mediave të shkuara."

Shoqëria përmbartore JUSTITIA

Shpall ankandin, faza parë, për shitjen e pasurisë së palauajshme me këto të dhëna: Apartamenti nr.pas.7/21+1-4, z.k.8360, vol.26, fq. 204, me sip 138.40 m2, Tiranë në pronësi të Gentian Kujtim TOSKU

Cmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 116.256 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dy qind e pesëdhjetë e gjashtë) EUR.

Ankandi zhvillohet në datën 01.11.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartës gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890



Gjatë ceremonisë së djeshme në "Luarasi"

Anni Dasho Sharko: Fakulteti i ri i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, risitë e bashkëpunimet

"Luarasi" nis vitin e ri akademik, ceremoni mikpritëse për studentët

Rektori Et'hem Ruka: Do të jeni profesionistët e së ardhmes

Voltiza Duro

Universiteti "Luarasi" hapi dje dyert për të pritur qindra studentë, duke shënuar kështu fillimin e vitit të ri akademik 2018-2019. Nëpërmjet një ceremonie të mikpritëse, ky institucion elitari i arsimit të lartë nisi me sukses projektimin e ëndrrave të të rinjve, të cilët nëpërmjet diplomës së "Luarasit" do të sigurojnë një të ardhme profesionale të sigurt. Rektori i universitetit, Prof. Dr Et'hem Ruka në fjalën e tij përshëndetëse iu uroi suksese të gjithë studentëve. Ai theksoi se pas përfundimit të rrugëtimit akademik, të rinjtë do të jenë juristë, ekonomistë e informaticienë të shkëlqyer në tregun e punës. "Jemi shumë të nderuar që ju kemi këtu. Nuk kam parë ndonjëherë studentë më të mrekullueshëm sesa jeni ju në këtë sallë. Ju po vini si maturantë dhe të jeni të bindur se nga dyert e këtij institucioni do të dilni si juristë, ekonomistë dhe si teknologë të informacionit dhe inovacionit. 'Luarasi' është një ndër katër shkollat më të mira të larta në vend. Synimi është që të jetë një shkollë elitare, një shkollë ku transmetohen dije, ku gjithçka zhvillohet në rregull, në mënyrë të pastër dhe duhet të bëni maksimumin që të përfitonit sa më shumë që të bëheni profesionistët më të mirë të Shqipërisë", - tha Ruka në fjalën përshëndetëse.



Rektori i universitetit, Prof. Dr Et'hem Ruka, dje në fjalën përshëndetëse



DEGET NE MASTER
Në pjesën e programeve master, dy programet janë master profesional në siguri kibernetike dhe informacioni dhe master shkencor në teknologji informacioni dhe inovacioni. Për t'u gjendur sa më pranë studentëve, institucioni elitari i arsimit të lartë ka çelur 3 mastera profesionale në Fakultetin Ekonomik për vitin e ri akademik 2018-2019.

CEREMONIA
"Ju po vini si maturantë dhe të jeni të bindur se nga dyert e këtij institucioni do të dilni si juristë, ekonomistë dhe si teknologë të informacionit dhe inovacionit. 'Luarasi' është një ndër katër shkollat më të mira të larta në vend. Synimi është që të jetë një shkollë elitare, një shkollë ku transmetohen dije, ku gjithçka zhvillohet në rregull, në mënyrë të pastër dhe duhet të bëni maksimumin që të përfitonit sa më shumë që të bëheni profesionistët më të mirë të Shqipërisë", - tha Ruka

këshillimit të karrierës në të gjithë Shqipërinë. Jemi shumë të kënaqur që kanë ardhur studentë të mrekullueshëm, me rezultate shumë të larta nga nota 8-10, çka na bën që këtë produkt ta kthejmë në përgjegjësi, në mësime, në kualitetin e përgatitjes së studentëve. Është një angazhim që ne e kemi marrë gjatë kësaj fushate promovuese dhe dua t'i siguroj studentët, por edhe prindërit e tyre që këta maturantë që ulen për herë të parë sot në auditorë, do jenë profesionistët të së ardhmes", - tregon rektori.

MASAT
Më tej Prof. Dr. Et'hem Ruka bën me dije se Universiteti "Luarasi" i ka marrë

të gjitha masat që gjithçka të shkojë perfekt gjatë procesit mësor dhe shton me bindje se në këtë institucion elitari studentët do të gjejnë atë çka kanë ëndërruar. "Detyra jonë është që ëndrrat e tyre t'i kthejmë në realitet. Do të doja me gjithë zemër të uroja suksese për studentët dhe të dalin me 10-ta nga rrugëtimi akademik, sepse në fund të fundit këta të rinj do ndryshojnë Shqipërinë", - thotë Ruka.

FAKULTETI I RI
Për t'u gjendur sa më pranë nevojave të tregut, Universiteti "Luarasi" çel këtë vit edhe fakultetin më të ri, atë të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Zv.rektorja për kërkimin shkencor pranë

këtij universiteti, Anni Dasho Sharko tregon se bashkëpunimet nuk do të mungojnë për të ndërthurur sa më shumë teorinë me praktikën. "Dita e parë ishte një kënaqësi për të gjithë ne pedagogët, plot me emociione njëkohësisht. Është dita e parë edhe për hapjen e fakultetit më të ri, atij të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Informatika Ekonomike dhe Teknologjia e Informacionit janë dy programe bachelori, të cilët ishin sot (dje) së bashku për të ndarë idenë si do të shkojmë bashkë gjatë tri viteve, si do të qasemi në konceptin e ri që jo vetëm mësojmë, por edhe punojmë; në konceptin që jo vetëm mësojmë, por jemi edhe pjesë

e akademisë Cisco, e akademisë Microsoft. Pra, jo vetëm mësojmë, por jemi edhe pjesë e qendrës së Inovacionit që do të vijë së shpejti në fakultetin e ri të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, që është një risi për studentët", - thotë Sharko.

Vetë studentët që ulen për herë të parë në auditorët e "Luarasit" e shohin këtë universitet si çelësin kryesor që do të hapë dyert për të ardhmen e tyre profesionale. "Jam studente në vitin e parë në Fakultetin e Drejtësisë dhe jam shumë e lumtur që jam pjesë e 'Luarasit'. Godina është fantastike, por mbi të gjitha pedagogët janë të mrekullueshëm dhe shumë miqësorë. Unë zgjodha Luarasin, pasi është një ndër universitetet më të mira në Shqipëri dhe e shoh si institucionin që do më sigurojë të ardhmen", - tregon një prej studenteve. Ata, plot emociione tregojnë se ndihen shumë të lumtur që janë pjesë e këtij institucioni elitari. "Unë kam zgjedhur të

vazhdoj studimet në degën e Teknologjisë së Informacionit, pasi e kam pasion këtë degë. Jam shumë i emocionuar, por mund të them se 'Luarasi' është një universitet elitari, prandaj bëra këtë zgjedhje", - thotë një tjetër student i vitit të parë. Me fillimin e vitit të ri akademik 2018-2019, 'Luarasi' vijon misionin e tij, edukimin dhe përgatitjen e të rinjve profesionistë në tregun e punës, me një staf të specializuar e standarde bashkëkohore.

PROGRAMET MASTER
Në pjesën e programeve master, dy programet janë master profesional në siguri kibernetike dhe informacioni dhe master shkencor në teknologji informacioni dhe inovacioni. Për t'u gjendur sa më pranë studentëve, institucioni elitari i arsimit të lartë ka çelur 3 mastera profesionale në Fakultetin Ekonomik për vitin e ri akademik 2018-2019. Tri degët e reja në ciklin e dytë të studimeve janë Marketing dhe Reklamë, Financë dhe Menaxhim Risku si dhe Kontabilitet.

Ministria e Shëndetësisë: Jo më pak se 10 vjet përvojë në specialitetin përkatës

Voltiza Duro

Nis gara për 41 drejtues shërbimesh mjekësore në QSUT, zbardhen kriteret

“Ja dokumentacioni që duhet të dorëzojnë aplikantët”

Deri në 5 nëntor, të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të fitojnë një pozicion si drejtues shërbimi në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” mund të aplikojnë duke dorëzuar dokumentacionin përkatës. “Gazeta Shqiptare” publikon sot listën e plotë me shërbimet e QSUT-së, në të cilat ofrohet pozicioni i punës drejtues shërbimi. Ndërkohë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka zbardhur kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët si dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë prej datës 19 tetor. Përkatësisht gara do të vijojë për të fituar një pozicion në një nga 41 drejtuesit e shërbimeve mjekësore në QSUT. “Data e aplikimit për procedurën e përzgjedhjes së kandidatave për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare do të jetë nga data 19.10.2018 ora 09:00, deri më 05.11.2018, ora 16:00. Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë zyrës së burimeve njerëzore të Fakultetit të Mjekësisë. Data e zhvillimit të konkurrencës do të jetë data 19.11.2018, dhe në vijim”, theksohet në njoftim.

KRITERET DHE DOKUMENTACIONI

Kandidati i interesuar duhet të ketë një përvojë klinike/diagnostike jo më pak se 10 vjet në specialitetin përkatës, ku të përcaktohet qartësisht specialiteti ku është ushtruar aktiviteti mjekësor dhe data e nisjes dhe përfundimit (nëse ka përfunduar) të eksperiencës përkatëse. Kështu, aplikantët duhet të dorëzojnë një kërkesë me shkrim të shoqëruar me fotokopjen e dokumentit të identifikimit, një curriculum vitae, diplomë në “Mjekësi të Përgjithshme”, diplomë e



specialitetit të shërbimit, diplomë e titullit “Profesor”, (nëse ka); diplomë e titullit “Profesor i Asociuar”, (nëse ka); diplomë “Doktoratë”/PhD, të mbrojtur në një nga Universitetet e Shqipërisë, të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Turqisë, Australisë ose Japonisë. Sakaq, diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë njohur dhe njehsuar, sipas legjislatcionit në fuqi nga strukturat përkatëse. Kandidatët që kanë vetëm shtetësi të huaj duhet të paraqesin certifikatën e mbrojtjes së gjuhës shqipe, me përjashtim të rasteve kur kandidati ka kryer një cikël të plotë studimesh në gjuhën shqipe dhe paraqet diplomën e noterizuar. Ndërkohë, kandidati duhet të dorëzojë nga Urdhri i Mjekut edhe licencën e ushtrimit të profesionit, vërtetim anëtarësimi

nga Urdhri i Mjekut si dhe një vërtetim që nuk ka asnjë dënim të dhënë nga ky institucion. “Duhet të dorëzohet kontrata ose vërtetimi që është mjek pedagog me kohë të plotë jo më pak se 5 (pesë) vjet, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar në IAL-në përkatëse dhe të ketë të njëjtin specialitet në shërbimin shëndetësor universitar, për të cilin kandidon, ose të jetë/të ketë qenë mjek pedagog me kohë të plotë i strukturave universitare homologe të Bashkimit Evropian ose vendeve anëtare të OECD. Në rastet kur asnjë nga pjesëtarët e stafit mjekësor nuk plotëson kriterin e sipërpërmendur, mund të pranohen edhe kandidatë me përvojë akademike, jo më të shkurtër se 8 (tetë) vjet, pa ndërprerje si pedagog me kohë të pjesshme”, thekson

MSHMS. Ndërkohë, konsiderohet si përvojë akademike aktiviteti didaktik i kryer në institucione publike të arsimit të lartë apo në institucione jopublike të arsimit të lartë, të akredituara dhe në programe studimi të akredituara brenda vendit, në periudhën e përvojës së kryer. I njëjti kriter vlen edhe për institucionet dhe programet e akredituara/e njohura në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose vendet anëtare të OECD. Nevojitet që kandidatët të mos kenë asnjëherë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë dhe më tej duhet të paraqesë edhe dokumentet që provon aftësitë profesionale dhe organizative. Projekti 4-vjeçar për zhvillimin dhe drejtimin e shërbimit i paraqitur nga i interesuari duhet të paraqesë të dhëna dhe produkte konkrete të matshme, të cilat do të shërbejnë më pas si bazë për vlerësimin e punës së drejtuesit të ardhshëm të shërbimit që i ka paraqitur ato. “Kërkesa dorëzohet pranë zyrës së burimeve njerëzore të fakultetit, pjesë e të cilit është shërbimi ku do të konkurrojnë. Kujdes! Dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë në origjinal ose kopje e noterizuar në gjuhë shqipe. Në rast paraqitjeje dokumentacioni në gjuhë të huaj, ky i fundit duhet të dorëzohet i përkthyer dhe noterizuar”, nënvizohet në shpalljen e ministrisë.

LISTA E SHËRBIMEVE TË QSUT

1. Shërbimi i Kardiologji I
2. Shërbimi i Kardiologji II
3. Shërbimi i Kardiokirurgjisë
4. Shërbimi i Kirurgjisë Vaskulare
5. Shërbimi i Gastrohepatologjisë
6. Shërbimi i Hipertonisë dhe Mjekësisë Interne
7. Shërbimi i Endokrinologjisë
8. Shërbimi i Nefrologjisë dhe Hemodializës
9. Shërbimi i Laboratorit të Immunologjisë
10. Shërbimi i Laboratorit të Gjenetikës
11. Shërbimi i Urgjencave Polivalente
12. Shërbimi i Anestezisë Reanimacionit
13. Shërbimi i Kirurgjisë së Përgjithshme I
14. Shërbimi i Kirurgjisë Urologjike II
15. Shërbimi i Kirurgjisë së Përgjithshme dhe Digestive III
16. Shërbimi i Dëgjimit dhe Dëgjimit
17. Shërbimi i Laboratorit Klinik Biokimik
18. Shërbimi i Laboratorit Mikrobiologjik
19. Shërbimi i Imazherisë dhe Mjekësisë Nukleare
20. Shërbimi i Toksikologjisë Klinike
21. Shërbimi i Laboratorit të Anatomisë Patologjike
22. Shërbimi i Neurologjisë
23. Shërbimi i Psikiatrisë
24. Shërbimi i Neurokirurgjisë
25. Shërbimi i Neurovaskular (Stroke dhe Post Stroke)
26. Shërbimi i ORL
27. Shërbimi i Okulistikës
28. Shërbimi i Pediatriës së Specialiteteve I
29. Shërbimi i Pediatriës së Specialiteteve II
30. Shërbimi Onkohematologjisë
31. Shërbimi i Nefrologjisë Dhe Dializës Pediatricë
32. Shërbimi i Kirurgjisë Infantile Pediatricë
33. Shërbimi i Reanimacionit Pediatric
34. Shërbimi i Urgjencës dhe Pediatriës së Përgjithshme
35. Shërbimi i Pediatriës Infektive
36. Shërbimi i Onkologjisë
37. Shërbimi i Hematologjisë
38. Shërbimi i Sëmundjeve Infektive
39. Shërbimi i Reumatologjisë
40. Shërbimi i Alergologjisë
41. Shërbimi i Dermatologjisë



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Blerje e një makine numëruese dhe paketuese për monedhat metalike, si dhe shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë”

“Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3,060,000 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halli”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas datave të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Blerje e një makine numëruese dhe paketuese për monedhat metalike, si dhe shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 08 Nëntor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Blerje e një pajisje pirun elektrik për nevojat e Bankës së Shqipërisë”

“Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,996,800 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halli”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas datave të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Blerje e një pajisje pirun elektrik për nevojat e Bankës së Shqipërisë”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 09 Nëntor 2018, ora 14:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Grëfhet aktorja: Në këtë jetë i suksesshëm është ai që ka dëgjuar veten

Suela Bako: Pak dashuri, ju lutem! Klithma e tradhtisë në skenën shqiptare

“Unë nuk kam qenë kurrë “Edra” në jetën time”

Egla Xhemali

Vepra “Tri gra dhe Misugi” është e konceptuar në formën e tri letrave. Një e shkruar prej bashkëshortes, tjetra prej së dashurës, dhe një letër e së bijës, e cila rrëfen mënyrën sesi e ka ndier këtë histori dhe humbjen e së emës, “Tri gra” është një roman tronditës për pasionin njerëzor. Është historia tragjike e një pasioni të pamundur i shkruar në tri letra, që i drejtohen të njëjtin person nga tri gra të ndryshme. Në fillim të duket sikur kemi të bëjmë me një histori të zakonshme dashurie jashtë martese. Në fakt, Inoue do të japë verisonin e dashurisë së mallkuar, asaj që jo doemos do i rezistoj kohës. Kjo histori e jashtëzakonshme e letërsisë japoneze do të ngjitet me skenën e “Teatrit Eksperimental” në datat 18-19-21-25-26-27-28 tetor. “Tri gra dhe Misugi”, është një dramatikizim nga novela e famshme e shkrimtarit japonez Yasushi Inoue. Me aktorët Suela Bako, Romir Zalla, Anila Muçaj dhe muzika nga Elna Islamaj pritet që ky dramatikizim të jetë i paharueshëm. Për të folur për këtë shfaqje ekskluzivisht për “Gazeta Shqiptare” vjen Suela Bako, e cila rrëfen të fshehtat e punës intensive dhe adhurimit që ka për veprën japoneze. Përtej aktimit Bako na zbulon dhe disa “sekrete” të vogla të familjes.

Na tregoni diçka për subjektin e shfaqjes “Tri gra dhe Misugi”?

“Tri gra dhe Misugi” është dramatikizim i veprës së Inoues Yasushi që përkthehet në Shqipëri “Çiftja”. Është një veprë, e cila ka ardhur në Shqipëri herët. Unë nuk e dija para ‘90-ës, po më thanë që ka ardhur para këtij viti. Veprën e kam lexuar diku rreth 2005-2006 dhe më ka lënë mbresa të jashtëzakonshme. Përkthimi që unë kam lexuar është nga Helena Kadare ndërkohë që vepra që unë po vë në skenë është një dramatikizim i Anxhela Çikopanos, sigurisht me mua që kam konceptuar shfaqjen, si dhe këtë lloj vënie midis personazheve që garkullojnë dhe i vishen një personi që në rastin konkret qëllon të



Suela Bako

jem unë. Vepra në thelb ka tri letra që i dërgohen të njëjtit person. Këto letra vijnë nga tre gra të ndryshme sigurisht me një lidhje të ngushtë mes tyre që i drejtohen një burri, Misugit. Lidhja mes këtyre grave është që njëra prej tyre është gruaja e Misugit, tjetra është e dashura nga një lidhje jashtë martesore, ndërsa e fundit është vajza e të dashurës, e cila, në fakt, vinte dhe kjo si një femijë e një martese të prishur. Është një vepër e jashtëzakonshme, e thellë, e dashur. Vepra i ka hyrë qenies njerëzore femërore në palcë, në nje të nervit, në nje të ndjesisë, por pa lënë mënjane figurën e maskullit pasi përmes këtyre tre grave neve nuk njohim vetëm grua, po njohim dhe maskullin me pushtetin e tij. Njohim rëndësinë e maskullit në jetën e një femre dhe atë se çfarë mund të bëjë ose të zhbejë prezenca e tij në jetën e saj.

Sa e vështirë është të jesh nën petkun e një personazhi japonez?

Unë, në fakt, jam nën petkun e tri personazheve japonezë, të tri grave. Ato zhvillohen, transformohen në skenë. Mendoj që në këtë rast vështirësia qëndron pikërisht tek kalimi nga lëkura e njërës tek lëkura e tjetrës. Është sfida, por është kaq tunduese sa jam

shumë e lumtur që ia bëra vetes këtë dhuratë. Kam vite që e mendoj. Kur kam lexuar veprën sikur e pashë shfaqjen, se si ato gra mund të ngriheshin mbi mua edhe unë të isha mbi to apo nën to. Për vite me radhë kam tentuar, jam tërhequr, fati dhe zoti e deshi që ky të ishte viti i realizimit të kësaj ëndrre.

C’të veçantë kanë këto personazhe?

Ato janë sa të ndryshme, aq edhe të ngjashme. E them këtë pasi tek të treja gratë fshihet një ndjeshmëri e thellë, një shpirt i brishtë që në dukje kamuflon me një krenari, diku-diku edhe kokëfortësi. Janë gra, të cilat përmes këtyre tre letrave thënë në gjuhën e

teatrit përmes monologjeve në pamje të parë dalin si një gjë krejtësisht e qartë që nuk fshihet asgjë poshtë. Do të mjaftojnë vetëm 2-3 minuta për të kuptuar se do të mjaftojnë vetëm 2-3 minuta për të kuptuar se çfarë oqeani fshihet pas kësaj pike uji në dukje. I bashkon forca, energjia, dashuria, pasioni, ideja fikse për një dashuri ideale dhe i ndan perceptimi mbi këtë dashuri, të përjetuarit e dëshpërimit, zhgënjimit, tradhtisë i ndan, gjithashtu, mënyra se si hakmerren. Janë shumë të ndryshme në hakmarrje secila prej tyre e për mendimin e tyre mënyra që ato gjejnë është spektakolare. Askush nuk bën asgjë kundër maskullit që i drejtohet, përkundrazi e kanë sfidën me veten. Në përgjithësi kam përshtypjen se gratë e kanë sfidën me veten, kjo është një gjë që më tundon shumë. Gratë kanë nevojë të sfidojnë veten më shumë se këdo tjetër.

Cila është risia që sjell në Shqipëri shfaqja që do të vini në skenë?

Mbase është përkëdhelie, po parapëlqej të them që risia e kësaj shfaqje është fakti që vepra është konceptuar si një teatër brenda teatrit, jo për herë të parë në fakt pasi kemi parë shpesh teatër brenda teatrit, por në këtë formë besoj që është një risi. Fakti që është një aktor që

luan tre personazhe besoj që është një risi. Unë jam përpjekur shumë të ruaj idenë e një teatri dhome. Çfarë dua të them me këtë është një teatër ku spektatori është pjesë e tij dhe ku nuk merret vesh se ku është ulur spektatori e ku është ulur personazhi. Kjo do të thotë që janë të shkrirë me njëri-tjetrin. Jam shumë e interesuar dhe kurioze të di impaktin te spektatori, po nuk kam mundësi t’ju aq them tani se si do të ndihet i pesh-tjelluar në këtë mënyrë dhe në këtë vënie skenike. Salla ‘Gatë’ ta ofron në mënyrë të shkëlqyer këtë mundësi. Unë kam parë shfaqje atje dhe e kam ndjerë veten pjesë të shfaqjes prej faktit që ti do të shohësh aktorin, por pas aktorit është një spektatori dhe ti befasi komunikon me spektatorin dhe kjo bën që spektatorët të ndërveprojnë me njëri-tjetrin ashtu sikurse dhe aktorët. Në shtë e mi është një eksperiment dhe një moment shumë interesant në teatër që ta ndesh veten pjesë të shfaqjes duke qenë spektatori i saj. Gjithçka në skenë ndodh *live*. Kalojmë nga një personazh tek tjetri, në thelb kemi një aktor dhe një regjisor që po bën një shfaqje teatri dhe nuk e kuptojmë çfarë po ndodh e befasi shohim se si ky aktor e kjo regjisor shkrihen dhe bëhen vetë shfaqja. Një ide e imja e kësaj veprë që shpresoj të komunikoj është për të ndërtuar dy linja paralele mes personazheve të Inoues që janë Misugi dhe tri gratë e tij dhe personazhet e shfaqjes së teatrit, personazhit të regjisorit, aktore, asistent regjisorit dhe instrumentistës. Kemi një paralelizëm delikat, elegant, jo të sfuruar që mezi pres të shoh se si do komunikojë ky lloj paralelizmi. Gjithmonë kam qenë shumë e interesuar për marrëdhëniet njerëzore në jetën reale. Në këtë përpjekje marrëdhëniet njerëzore që krijohen në një ambient teatror mbase jo vetëm, por fakti që ti rri dhe konsumon ditën me të njëjtin njerëz ndan me to, punën, pasionin gjithçka e kjo bën që shpesh të krijohet një lloj kimie mes kolegëve që shkon përtej marrëdhënies ndërmjet tyre. Kjo më intereson ta nxjerr dhe jam përpjekur ta përcjell me shfaqjen time.




Kush e refuzon Kejvinën?

Që me daljen e saj të parë në televizion, Kejvina arriti të merrte menjëherë vëmendjen e të gjithëve dhe u etiketua si një prej vajzave më seksi në show bizz. Dhe jo pa arsye, ajo është mjaft simpatike e tërheqëse dhe është e vështirë të mendosh që një vajzë si Kejvina mund të refuzohet nga ndonjë mashkull. Por, së fundmi velina ka treguar vetë se përballet me refuzime çdo ditë. Nëpërmjet 'Instastori', ku ajo komunikon me ndjekësit e saj me pyetje dhe përgjigje, një prej ndjekësve e ka pyetur nëse është përballur ndonjëherë me refuzimin? "Për ditë por s'ma beson njeri", është përgjigjur Kejvina.



Dalin fotot e Tunës dhe Vildanes, a janë puthur vërtetë?

Jehona e puthjes lezbike mes Vildane Zenelit dhe Tunës në klipin më të fundit të këngëtares me Seven Saraqin, u komentua dhe krijoi mjaft zhurmë në mediat rozë, që para publikimit të klipit. Të gjitha spekulimet u drejtuan nga vajzat mjaft seksi, dhe të gjithë kemi pyetur veten nëse kanë qenë të vërteta puthjet mes tyre. Seven Saraqi i ka zbuluar të gjitha detajet e bashkëpunimit në emisionin "Sev-e-bizz". I pyetur nga moderatori i emisionit, Seveni ka rrëfyer se vajzat nuk janë puthur në të vërtetë, por vetëm janë përfqafuar dhe puthur mbi krevat.



Shpeshherë aktori flet me personazhet. Si ka qenë përbalja juaj me ta?

Eksperiencë e paparë. Aktori dhe regjisori në këtë rast kanë folur shumë me njëri-tjetrin. Fakti që kam në krah Romirin, që është bashkëshorti im, po kjo nuk ka lidhje fare pasi në punë ne jemi dy njerëz, të cilët e harrojmë njëri-tjetrin dhe jemi dy njerëz shumë të përkushtuar e të devotshëm në punën tonë. Ka qenë një mbështetje shumë e madhe për të gjitha vrimat e mia të zeza, të cilat herë-herë duken si mbyttëse, por me ndihmën e tij i kemi superiuar. Megjithatë ne e kemi shijuar shumë si një eksperiment teator. Patjetër që unë e kam provuar veten si regjisorë, pasi jam prej vitesh regjisorë në televizion. Kam 4-5 vite që tentoj dhe realizoj filma të shkurtër me ndërmendjen për të arritur tek një film i gjatë shumë shpejt. Unë jam regjisorë, por në rastin konkret duket si sfidë më e madhe pasi doja shumë që të realizoja dhe të sillja në skenë këto tri gra, të cilat kam përshtypjen që nuk më përfaqësojnë mua, por çdo grua. Për t'u kthyer përsëri te regjia, unë e kam shijuar shumë anën e konceptimit dhe realizimit të shfaqjes. Nuk jam vetëm, jam me Romirin kështu që nuk është aq dramatike sapo të mos ishte ai. Për mua kjo është tentative e parë në regji teatri dhe nga kjo pikëpamje, gjithashtu, është sfiduese.



Jam shumë e lumtur që arrita ta realizoj. Se si pak rëndësi ka, procesi është i rëndësishëm.

Kritika më e ashpër që kenë marrë?

Në lidhje me këtë shfaqje kritika më e ashpër që kam marrë është refuzimi, sepse unë kam tentuar të bashkëpunoj me regjisor që para një viti, por nuk e di nuk e kam gjetur veten. Janë steur, u është dukur një vepër letrare jo fort e përshtatshme për teatër. Gjithmonë refuzimi është një arsye për tu motivuar dhe jam singërisht shumë e lumtur që e kam realizuar. Kritikat I pres mbas shfaqjes, sepse unë nuk bëj një shfaqje për t'u kryer. Jo, unë bëj një shfaqje për të marrë kënaqësi. Kam gjëra që dua ti them, kjo është e rëndësishme shumë dhe po i them



nëpërmjet saj. Kjo shfaqje lind brenda meje, nuk lind nga forma apo për të bërë çudira, po lind nga nevoja për të thënë e për të komunikuar ndjesi shumë të rëndësishme njerëzore. Ato gjëra të cilat rrallëherë ia themi vetes me zë, unë marr

Pas kaq vitesh dashuri, ankohet akoma Romiri për "Edrën"?

Unë nuk kam qenë kurrë "Edra" në jetën time. Pavarësisht se shumë njerëz kur më njihnin për herë të parë thoshin "Ua nuk e kishim imagjinuar kështu Edrën!". (qesh) Të gjithë mendonin se realisht Romiri fliste për gruan e tij të vërtetë. Ndonjë çik "Edra" jemi ne, të gjitha femrat janë, por unë nuk e shoh veten si Edra. Ne kemi një raport shumë të mirë. Edhe fakti që jemi kolegë të së njëjtës fushë besoj që nuk na jep shumë mundësinë për të qenë shumë Edra, sepse ia dimë hallet njëri-tjetrit ia dimë shqetësimet, njohim profesionin vështirësitë. Në këtë sens unë nuk e ndiej fare veten Edra. Nuk besoj se kam

qenë ndonjëherë në jetën time Edra.

Përtej aktrimit, sa dinamike është jeta juaj?

Shumë dinamike. Sa herë ndihem e lodhur gjërat mbarojnë dhe kur nuk kam ndonjë gjë për të bërë filloj çmendem nga fakti që s'kam gjë për të bërë. Kështu që nuk mund të jetoj dot pa këtë dinamikë, falë zotit arrij ta përballoj atë. Aktualisht kam vetëm një javë që jam e fokusuar të shfaqja se kam pasur shumë gjëra të tjera nëpër duar. Është shumë e bukur dinamika e jetës sime. Kam vetëm një problem të vogël, që më bën të rri larg pak larg fëmijëve e kjo më trishton pak, por pjesë e jetës edhe kjo.

Çfarë amvise është Suela?

Është amvisë e mirë. (qesh) Me përjashtim të këtyre momenteve të tmerrshme kur nuk mundem të gatuaj, sepse nuk kam kohë. Suela është një familjare e devotshme pret, përcjell. Gatuan shtron dreka, i ngre ato. Vetëm kur jam shumë e impenjuar i refuzoj ato, por prap vjen jeta në ritmin e saj.

Porosia që u jepni më shpesh fëmijëve?

Unë jap shumë porosi fëmijëve. Të dëgjojnë veten e tyre, atë personin që fshihin brenda. Unë besoj shumë që në këtë jetë i suksesshëm është ai që ka dëgjuar veten pavarësisht se çfarë lloj suksesi ka qenë ai. E rëndësishme është të dëgjosh veten dhe t'i përgjigjes instinktit tënd. Unë them që nuk gabon lehtë instinkti.

Pastaj jeta është shumë e koklavitur dhe pa u përkushtuar në studim, në punë nuk arrin asgjë. Përpara asaj që prindërit thonë gjithmonë mëso, unë dua që ata të bëhen njerëz të mirë dhe të dëgjojnë veten e tyre, kjo është më e rëndësishmja.

Ka diçka që do kisht dashur ta ndryshonit nga rrjedha e kohës?

Ka momente që më duket sikur dua t'i ndryshoj të gjitha dhe ka momente që them se nuk dua të ndryshoj asgjë. Në fund të fundit unë jam kjo që jam sot, për hir të kësaj jete që kam bërë dhe kam jetuar fort, në mënyra të ndryshme, në përpëlitje të ndryshme mbase se herëherë nuk ka qenë e mundur të bëja punën që doja, që po e bëj këto 4-5 vitet e fundit në një vrull të frikshëm. Më është dashur të punoj në televizion. Edhe atje kam dhënë maksimumin tim. Nuk kam asnjë pishman, kam mësuar shumë dhe vazhdoj të mësoj. Është e lehtë të thuash që doja të bëja jetën e kësaj apo asaj, por jo. Unë do bëja prap po këtë jetë dhe do të përpiqesha po njësoj e të luftoja sërish kështu. Do kisha dashur që në atë jetën tjetër nëse do përsëritej ta kisha pak më të thjeshtë dhe më të lehtë jetën, pasi kjo që kam kaluar nuk ka qenë dhe aq e lehtë, por mbase nuk do isha kështu po mos të ishte e lehtë. (qesh)

Përkufizimi që do i jepni lumturisë?

Gëzohu me atë që ke.

Zgjedhjet në parlament, pritet "fundosja" e Unionit Krisitan-Social

"Humbet thellë" simotra e Angela Merkelit në Bavari

Kancelarja zotohet se do rifitojë besimin e gjermanëve

Ditën e djeshme, partia simotër e kancelares gjermane, Angela Merkel, Unioni Krisitan-Social (CSU) është përballur me humbje të madhe në zgjedhjet shtetërore të Bavarisë, bazuar në rezultatet e parakohshme. Partia e qendrës së djathtë pritet të humbë shumicën absolute në parlamentin shtetëror. Partia e të gjelbërve pritet të listohet në vendin e dytë, derisa partia me qasje kundër-migrantëve, Alternativa për Gjermaninë (AfD) pritet të jetë pjesë e parlamentit shtetëror për herë të parë. Anëtarët e partisë CSU kanë udhëhequr në Bavari pothuajse nga viti 1957. Mirëpo është thënë se kjo parti ka humbur mbështetjen për shkak të opinionëve të ndara në çështjen e migrimit. Lideri i kësaj partie, Horst Seehofer ka thënë se kjo nuk është ditë e mirë, por që gjithsesi është vetëm njëra anë e monedhës, pasi votat i japin "mandat të qartë" kësaj partie për të formuar qeverinë e re. Në rezultatet preliminare është parë se CSU-ja ka fituar rreth 37 për qind të votave, 10 për qind më parë se katër vjet më parë. Partia e të gjelbërve ka fituar 18 për qind të votave, derisa Alternativa për Gjermaninë është listuar e katërta me rreth 10 për qind të votave, përkatësisht pas kandidatëve të pavarur. Partnerët e koalicionit kombëtar të Merkelit, social-demokratët e qendrës së majtë (SPD) janë renditur në vendin e pestë me më pak se 10 për qind të votave të fituara. Pas publikimit të rezultateve, ka pasur spekulime se SPD-ja mund të largohet nga Qeveria gjermane, duke tentuar të shpëtojë si parti. Kancelarja gjermane, Angela Merkel, tha të



Angela Merkel



Horst Seehofer

ANGELA MERKEL

"Mësimi im nga kjo është se unë si kancelare duhet të siguroj rikthimin e besimit. Do të punoj për këtë me gjithë energjinë që kam", tha kancelarja Angela Merkel në një takim me përfaqësuesit e industrisë gjermane.

10

PERQIND

Në rezultatet preliminare është parë se CSU-ja ka fituar rreth 37 për qind të votave. Partia e të gjelbërve ka fituar 18 për qind të votave, derisa Alternativa për Gjermaninë është listuar e katërta me rreth 10 për qind të votave. Partnerët e koalicionit kombëtar të Merkelit, social-demokratët e qendrës së majtë (SPD), janë renditur në vendin e pestë me më pak se 10 për qind të votave të fituara.

hënën se humbja e madhe e aleatëve të saj konservatorë në rajonin e Bavarisë tre-

gon se votuesit e kanë humbur besimin në qeveri dhe premtoi se do të luftojë për ta rifituar atë. "Mësimi im nga kjo është se unë si kancelare duhet të siguroj rikthimin e besimit. Do të punoj për këtë me gjithë energjinë që kam", tha Merkel. Komentet vijnë pasi partia simotër e Merkelit pësoi të di-

elën humbje të madhe në zgjedhjet shtetërore të Bavarisë, duke shkaktuar pasiguri në koalicionin qeverisës. Me gati të gjitha votat e numëruara, Unioni i Krishterë Social humbi shumicën absolute në Parlamentin e Bavarisë, të cilën e ka që nga viti 1957. Të gjelbërit u ngritën në vendin e

dytë, ndërsa partia anti-migrante, Alternativa për Gjermaninë, do të futet për herë të parë në parlamentin bavarez. Sipas analistëve, shoqëria gjermane ka nisur të ndahet thellësisht që nga viti 2015, kur Merkel ka hapur dyert e Gjermanisë për mbi një milion emigrantë, kryesisht myslimanë nga Lindja e Mesme.

SHKURT

Brexit, Britania e BE-ja dështojnë në arritjen e paktit

Duke qenë se ende nuk është arritur "dalja" finale, ditën e djeshme Britania dhe Bashkimi Evropian kanë dështuar të arrijnë një marrëveshje për Brexit, në bisedimet e paplanifikuara vetëm disa ditë para samimit vendimtar të BE-së. Në takimin e realizuar të hënën mes negociatorit të BE-së, Michel Barnier dhe sekretarit britanik për Brexit, Dominic Raab, së bashku me 27 ambasadorë tjerë evropianë në Bruksel, është spekuluar arritja e një marrëveshjeje të mundshme për të vendosur kushtet e largimit të Britanisë nga BE-ja. Barnier ka thënë përmes një postimi në "Twitter" se "pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme, disa çështje kyçe janë ende të hapura". Ai ka thënë se çështja që ndan të dyja palët është nevoja e "anashkalimit të një kufiri të ashpër" mes të Irlandës Veriore në Britani dhe Republikës së Irlandës pas Brexittit. Qeveria britanike ka thënë se ende ka "çështje të pazgjidhura", mirëpo ka insistuar se negociatorët kanë bërë "përparim të vërtetë" drejt arritjes së paktit. Irlanda është anëtare e BE-së dhe aktualisht ekziston një "kufi i butë" mes të këtij vendi dhe Irlandës Veriore, pa formalitete doganore. Kryeministria britanike, Theresa May është duke u përballur me presion nga shumë anëtarë të Partisë Konservatore për të mos bërë ndonjë lëshim ndaj BE-së, sidomos në çështjen e kufijve. Këto bisedime të vështira e lënë të hapur mundësinë për Brexit "pa marrëveshje", duke e bërë të paqartë marrëdhënien e bllokut evropian me këtë shtet në tregti dhe aspekte tjera, pasi Britania të largohet nga BE-ja. May ndërkohe ka planifikuar mbajtjen e një takimi me kabinetin e tij më 16 tetor, një ditë para samimit të BE-së. Përndryshe, Britania e Madhe pritet të largohet nga BE-ja në fund të marsit të vitit të ardhshëm.

PËRMBYTET FRANCA, 6 VIKTIMA NGA PËRMBYTJET NË JUG

Vijojnë katastrofat natyrore në Europë. Në jug të Francës të paktën 6 persona humbën jetën në komunën e L'Aude, si pasojë e shirave të rrëmbyeshëm që shkaktuan përmbytje. Disa qindra banorë u evakuuan nga autoritetet franceze, ndërsa e gjithë komuna është vendosur në alarm të kuq, më i rëndi në nivelin e sigurisë. Sipas mediave franceze, më shumë se 222 mm shi ra mbrëmjen e së dielës në vetëm pak orë, duke provokuar daljen e lumit nga shtrati.



FOTOLAJM

Trenditet Greqia, dy tërmete godasin Selanikun

Dy tërmete të njëpasnjëshme kanë goditur Selanikun mesditën e sotme. Sipas Institutit të Gjeologjisë në Greqi, tërmeti i parë ka qenë me magnitudë 4.1 në një thellësi prej 2 kilometra. Lëkundjet sizmike janë ndjerë më shumë në Halkidiki, pasi gjendet pranë epiqendrës, por edhe në Selanik. Pak minuta më vonë, ra një tjetër tërmet me magnitudë 3.1 i shkallës Richter me epiqendër në Halkidiki në një thellësi prej 10 kilometra. Nga tërmeti nuk ka raportime për persona të lënduar dhe për dëme materiale.

Peshkopi Timotej: Gjithçka, në dorë të Patriarkanës së përgjithshme

Dy kishat ortodokse të Ballkanit duan pavarësi

“Përplasja” mes Maqedonisë e Malit të Zi me atë serbe

Njohja e Kishës Ortodokse Autoqefale të Ukrainës nga ana e Patriarkanës Ekumenike të Stambollit, me në krye Patriarkun Ekumenik Bartholome dhe kundërshtimi i Kishës Ortodokse ruse, se një ndarje e tillë mund të çojë në shkatërrimin e botës ortodokse, ka vënë në fokus dy raste të ngjashme në Ballkan: kërkesat për pavarësi të Kishës Ortodokse të Maqedonisë dhe Kishës Ortodokse të Malit të Zi. Të dyja këto kisha janë nën Kishën Autoqefale të Serbisë. Peshkopi i Dibrës dhe Kërçovës, Timotej, për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë ka thënë në shtator se kjo situatë hap rrugën për Autoqefalinë e Kishës Ortodokse maqedonase. “Kjo nënkupton që Kisha Ortodokse e Maqedonisë të jetë e njohur nga pjesa më e madhe e kishave ortodokse si një kishë e barabartë, e cila mund të kryejë shërbesa dhe të komunikojë në mënyrë të barabartë. A pajtohet apo jo Kisha Ortodokse serbe me këtë, kjo nuk duhet të na shqetësojë, pasi është një çështje që nuk e zgjidhim ne, por Patriarkana e përgjithshme”, ka thënë peshkopi Timotej. Nënkrjetari i Këshillit Metropolit të Kishës Ortodokse të Malit të Zi ka thënë për agjencinë “MIA” se, “akti historik i Patriarkanës së Stambollit nuk mund të mbetet pa u nderuar”. “Eksistojn tendenca që çështjet e Kishës që po e

ngarkojnë botën ortodokse, përfshirë edhe çështjen e Kishës Ortodokse maqedonase dhe malazeze, përfundimisht të gjejnë një zgjidhje të kënaqshme”, ka thënë nënkryetari i Këshillit Metropolit të Kishës Ortodokse të Malit të Zi. Kisha Ortodokse Autoqefale e Serbisë e kundërshton vendimin për njohjen e Kishës Ortodokse të Ukrainës nga ana e Patriarkanës Ekumenike të Stambollit. Patriarku Ekumenik Bartholome e ka dhënë pëlqimin për pavarësinë e Kishës Ortodokse të Ukrainës dhe ky lajm është mirëpritur në Ukrainë. Presidenti i Ukrainës, Petro Poroshenko, ka thënë se për këtë vendim kanë “ëndërruar gjatë”, ndërkaq Moskë ka thënë se bëhet fjalë për një “katastrofë”. Nga ana tjetër, në fund të shtatorit, kisha ortodokse serbe kishte njoftuar më 27.9.2018, një aktivitet të saj në Kalanë e Ulqinit. Ky njoftim ishte publikuar nëpërmes faqes në “Facebook” “Pravoslavnij Ulcinj”. Po në të njëjtën



Patriarkun Ekumenik Bartholome

faqe mund të lexohej një njoftim tjetër për një ndalesë të aktivitetit të lartpërmendur nga ana e Komunitetit të Ulqinit, shkruan “Ulqini Online”. “Të dashur vëllezër e motra, komuna e Ulqinit ka ndaluar shërbimin e adhurimit nesër në Krstovdan në Qytetin e Vjetër. Shërbimi do të bëhet në katedrale në orën 9:00. Ju lutemi mos kr-

ijoni tension në lidhje me këtë vendim, sepse gjatë ditëve në vijim do të përipiqemi të zgjidhim problemin me institucionet kompetente në mënyrë të ligjshme për të ardhmen. Forca nuk qëndron në fuqi, por në qetësi dhe durim”, kështu citohet prifti Sinisha Smilij nga faja në “Facebook” “Pravoslavnij Ulcinj”. Kohë më parë në

Shas ka ndodhur të një incident, ku banorët vendës protestuan për një aktivitet të përfaqësuesve të së njëjtës kishë. Po nga e njëjta kishë në vitin 2013, në Martinaj të Plavë Gucisë, kishin ndodhur arrestime të dhjetëra shqiptarëve nga ana e policisë malazeze. Arrestimet kishin ndodhur pasi shqiptarët e kësaj treve kanë kundërshtuar

PESHKOPI TIMOTEJ

“Kjo nënkupton që Kisha Ortodokse e Maqedonisë të jetë e njohur nga pjesa më e madhe e kishave ortodokse si një kishë e barabartë, e cila mund të kryejë shërbesa dhe të komunikojë në mënyrë të barabartë. A pajtohet apo jo Kisha Ortodokse serbe me këtë, nuk duhet të na shqetësojë, pasi këtë nuk e zgjidhim ne, por Patriarkana e përgjithshme”, ka thënë peshkopi Timotej.

ndërtimin e Kishës Ortodokse serbe në pronësi të familjes Prelvukaj. Ndërkohë, mbetet i hapur “tension” mes autoqefaleve, ku në përfundim zgjidhja mbetet në dorë të Patriarkanës së përgjithshme, e cila ende s’ka dhënë reagimin e saj lidhur me rastin në fjalë.

Vuçiç: Ushtria e Kosovës paraqet frikë për serbët Presidenti i Serbisë: Partnerët gjurmojnë për anëtarësimin e kosovarëve në Interpol

Aleksandar Vuçiç, Presidenti i Serbisë, ka pranuar se janë në situatë të vështirë në lidhje me krijimin e ushtrisë së Kosovës. Në një deklaratë Vuçiç ka thënë se janë në situatë të vështirë në lidhje me krijimin e ushtrisë së FSK-së. “Paralajmërimet nga Kosova rreth formimit të ushtrisë ngjallin frikë tek serbët”, deklaroi ai. Vuçiç pranoi se Serbia gjendet në situatë të vështirë. “Disa prej partnerëve tanë perëndimorë janë duke u përpjekur që Kosova të jetë anëtare e Interpolit”, është shprehur transmeton “lajmi.net”. Serbia planifikon që për këtë arsye, ministri i Punëve të Jashtme, Ivica Dačić do të ketë më shumë udhëtime gjatë kësaj jave, kurse me angazhime do të jenë edhe ministri i Punëve të Brendshme, njësoj si

kryeministria. Vuçiç ka thënë se në lidhje me këto tema ka paralajmëruar edhe sekretarin e përgjithshëm dhe se nuk ka më shumë çfarë të shtojë për serbët në Kosovë. “Nuk do t’i lejojmë njerëzit tanë pa mbështetje, do të bëjmë gjithçka që të mos arrihet deri të ndonjë sjellje e papërgjegjshme”, theksoi ai. Nga ana tjetër, Forca e Sigurisë së Kosovës është prej kohësh në kërkim të plotësimin të vendeve të lëna bosh nga pjesëtarët e komunitetit serb, të cilët dytre muajt e fundit kishin braktisur radhët e saj. Rreth 100 pjesëtarë të FSK-së nga komuniteti serb e kishin braktisur këtë forcë, sipas tyre, për shkak të presioneve që ishin ushtruar ndaj tyre nga autoritetet serbe në Beograd. Megjithatë, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem



Berisha, thotë se ka interesim nga të rinjtë serbë për të qenë pjesë e ushtrisë së Kosovës. Sipas tij, për procesin e tanishëm të transformimit të FSK-së kjo çështje nuk është problem. “Realisht, interesimi është shumë i madh për plotësimin e vendeve të punës dhe ne si FSK, unë si ministër dhe stafi im jemi shumë të përkushtuar që t’i plotësojmë këto vende sa më parë dhe të hapim konkursin për

plotësimin e vendeve të punës nga komuniteti joshumicë, realisht nga komuniteti serb”. “Më vjen keq që ata kanë marrë një vendim të tillë pa dëshirën e tyre, por me ndikime nga jashtë. Mendoj se me vendimin për tranzicion të FSK-së, serbët nuk do të kenë më presion për ta lëshuar Forcën e Sigurisë së Kosovës”, thotë Berisha. Ai shprehet gjithashtu, se aktualisht në Kuvendin e Kosovës pritet të shqyrtohen dhe miratohen tri projektligje që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së. Bëhet fjalë për Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ligjin për Shërbim dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin për transferimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë në Ministri të Mbrojtjes.

Maqedoni, rinisi debati për ndryshimet kushtetuese

Ditën e djeshme parlamenti i Maqedonisë nisi debatin për ndryshimet e propozuara kushtetuese, lidhur me ndryshimin e emrit në marrëveshjen me Greqinë. Në qershor të këtij viti, qeveritë e të dy vendeve arritën një marrëveshje, në bazë të së cilës Athina ra dakord për tërheqjen e pengimit të anëtarësimin të Maqedonisë në NATO dhe Bashkimin Evropian, në këmbim të ndryshimit të emrit në “Republika Veriore e Maqedonisë”. Më 30 shtator, maqedonasit dolën në referendumin që do të përcaktonte orientimin e Maqedonisë, i cili dështoi si rezultat i moskallimit të pragut prej 50 për qind. Përkundër kësaj, kryeministri maqedonas, Zoran Zaev u betua se do të vazhdojë ta shtyjë këtë proces përpara me anë të amendamenteve kushtetuese, siç kërkohet në marrëveshjen me Greqinë. Ende është e paqartë nëse koalicioni social-demokrat, që përfaqësohet edhe nga shqiptarët, do të ketë shumicën apo dy të tretat në parlament, për të kaluar ndryshimet e propozuara. Zaevit do t’i duhet edhe mbështetja e dhjetëra deputetëve nga VMRO-DPMNE, partitë opozitare që kanë bërë fushatë kundër ndryshimit të emrit. Ndërkaq, përfaqësuesja e Politikës së Jashtme në Bashkimin Evropian, Federica Mogherini, në një intervistë për një agjencinë maqedonase, ka ritheksuar mbështetjen e marrëveshjes mes Athinës dhe Shkupit, duke shtuar se kjo ka qenë një “mundësi unike për pajtim në Ballkanin Perëndimor, gjë që mund të mos ndodhë më”.

LIBRI MË I RI "SHKRIMTARËT NËN DIKTATIN KOMUNIST"


Ekskluzive/ Raporti i vitit 1973, ku sekretari i parë i Mirditës, Jovan Bardhi informon Komitetin Qendror

"Pse u lejua kryeartikulli i Xhevahir Spahiut në 'ZP', pasi ai u kritikua nga shoku Enver"

Denoncimi: Në revistën "Shqiptarja e Re", botohen edhe modele të modës së huaj në veshje

DASHNOR KALOÇI

Ai lloj liberalizmi që u vu re, apo u lejua po themi nga regjimi komunist Tiranës në fundin e viteve '60-të dhe fillimin e viteve '70-të, gjë e cila preku pothuaj të gjithë jetën e vendit dhe normalisht edhe artin, kulturën dhe letërsinë, ndaloj si me komandë në janarin e vitit 1973, kur Enver Hoxha hodhi kritikën e para ndaj Festivalit të 11 Kombëtar të Këngës në Radio Televizion. Ky festival për të cilin mund të thuhet se ishte dhe "maja" e liberalizmit në jetën artistike e kulturore të vendit dhe u prit mjaft mirë e me shpresa të mëdha si nga rinia, ashtu edhe nga ajo pjesë e inteligjencës shqiptare, që ndiqte me vëmendje hapat dhe kursin politik që po ndërmerre regjimi komunist i Tiranës, pas kritikave të para të "udhëheqësit kryesor", befas u shndërrua në një "tabelë qitjeje" si nga udhëheqja e lartë, ashtu edhe nga e gjithë hierarkia partiake e sistemit deri në organizatat bazë dhe gjithashtu nga të gjitha organizatat e masave që ishin nën varësi dhe nën komandën e Partisë. Kritikën dhe goditja që iu dha Festivalit të 11 të Këngës u pasuan nga fjala e Enver Hoxhës e mbajtur më 15 mars të po atij viti në aparatën e Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe më pas në Plenumin e III të Komitetit Qendror të PPSH-së, ku si temë kryesore ishte "Lufta ndaj shfaqjeve të huaja dhe liberale, në art, kulturë dhe letërsi". Ashtu siç do të shohim edhe në mjaft nga kapitujt pasardhës të këtij libri, fjala e Enver Hoxhës e 15 marsit dhe ajo në Plenumin e III "pati një jehonë të madhe" në të gjithë jetën e vendit dhe si rezultat u mbajtën mbledhje të shumta jo vetëm nga institucionet kulturore dhe artistike të Tiranës dhe në mbarë vendin, por edhe nga të gjitha komitetet e partisë në rrethe dhe dikastere e institucione të ndryshme, organizatat bazë, si dhe nga të gjitha organizatat e masave, si p.sh. Bashkimi i Rinisë së Punës së Shqipërisë, Bashkimet Profesionale, Organizata e Gruas, Organizata e Veteranëve etj. Në këtë kontekst të zhvillimit të ngjarjeve, asokohe u mbajt edhe mbledhja e Plenumit të Komitetit të Partisë së Rrethit



Xhevahir Spahiu

të Mirditës, e cila zhvillohej pas sërë mbledhjesh që ishin bërë në atë rreth si nga organizatat bazë, ashtu edhe ato të masave. Lidhur me këtë bën fjalë dokumenti arkivor që po publikojmë në këtë kapitull, ku sekretari i parë i Komitetit të Partisë së Rrethit të Mirditës, Jovan Bardhi, informon Komitetin Qendror të PPSH-së lidhur me zhvillimin e atij plenumi dhe e gjithë problematika që ka dalë në atë mbledhje. Siç do të shohim edhe nga dokumenti në fjalë, ajo që vihet re aty, ndryshe nga shumë rrethe të tjera, ku nëpër mbledhjet që janë zhvilluar në atë kohë pikërisht për të njëjtën temë ("Lufta kundër shfaqjeve të huaja nën frymën e fjalimit të shokut Enver Hoxha në Plenumin e III të Komitetit Qendror të Partisë dhe Presidiumin e Kuvendit Popullor, për problemet e kulturës, letërsisë dhe arteve") nuk është diskutuar dhe janë ngritur probleme për çështje që preokuponin vetëm rrethin e Mirditës si p.sh., "rastet e vjedhjes nga nxënësit në konviktet e shkollave të mesme të Rubikut e Rrëshenit", "vjedhjes së lekëve të një mësuesi nga nxënësit e shkollës së Rubikut", "vjedhjes së dyqanit të Repsit nga nxënësit e shkollës 8-vjeçare të atij fshati", "moda e flokëve dhe favoriteve të gjata", "mosrealizimet e planeve të

ndërmarrjeve dhe minierave të rrethit", "kuadrot që kërkonin të largoheshin nga rrethi i Mirditës" etj., etj., por edhe për probleme nga më të ndryshmet të artit e kulturës në shkallë vendi. Kështu, sipas raportit të Jovan Bardhit, nga komunistët dhe kolektivat punonjës të Mirditës janë ngritur probleme dhe është diskutuar gjatë edhe për revistat "Nëntori", dhe "Shqiptarja e Re", Radio-Televizionin Shqiptar, madje deri për gazetën "Zëri

Së shpejti libri më i ri, "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist", i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

i Popullit", e cila "nuk duhet ta kish të botuar kryeartikullin e Xhevahir Spahiut, pikërisht pas kritikës që iu bë atij nga shoku Enver". Lidhur me këtë dhe të tjera nga ato çka janë diskutuar në Plenumin e Komitetit të Partisë së Mirditës në një dokumenti në fjalë, i cili publikohet me shkurtime dhe ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare", ku nëntitujt janë redakionale dhe të nxjerra në mënyrë integrale nga dokumenti arkivor.

Raport-informacioni i sekretarit të parë të Mirditës, Jovan Bardhi, për Komitetin Qendror të PPSH-së

DISA PROBLEME QË DALIN NË RRETHIN E MIRDITËS PËR LUFTËN KUNDËR ÇFAQJEVE TË HUAJA NË FRYMËN E FJALIMIT TË SHOKUT ENVER NË



PLENUMIN E 3-TË TË K.Q. DHE NË PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR, PËR PROBLEMET E KULTURËS LETËRSISË DHE ARTEVE

Fjalimi i shokut Enver Hoxha, mbajtur në Plenumin e 3-të të Komitetit Qendror të Partisë dhe Presidiumin e Kuvendit Popullor për problemet e kulturës, letërsisë dhe arteve u punua dhe u zbrëthye nga shokët e Plenumit, Aparatit, të organizatave të masave, sekretarët e organizatave bazë të Partisë dhe me të deleguarit në shkallë rrethi. Në të njëjtën kohë u dhanë orientimet se si duhet të punohej për njohjen, zbrëthimin dhe zbatimin e tyre dhe për organizimin e diskutimit të këtyre problemeve në organizatat bazë të Partisë dhe në masat.

Mbas studimit të hollësishtë të fjalimeve të shokut Enver, Byroja e Komitetit të Partisë së Rrethit, në mbledhjen e saj të zgjeruar me pjesëmarrjen e përgjegjësve të organizatave të masave dhe të sektorëve në aparatën e Komitetit të Partisë, u ndal në çfaqjet e huaja, në shkaqet, në burimet dhe në punën që duhet zhvilluar kundër tyre.

"KA RASTE QË NXËNËSIT VJEDHIN EDHE LEKËT E MËSUESIT"

Raste vjedhjesh ka edhe nga nxënësit. Kështu, thyhet dyqani i shitblerjes nga një grup nxënësisht të shkollës 8-vjeçare Reps. Në Rubik ka pas raste kur nxënësit të veçantë ose në grup vjedhin. Një rast, edhe lekët e mësuesit. Vjedhje nga nxënësit ka edhe te njëri-tjetri si lekë, plaçka, sidomos në konviktin e shkollës së mesme, Rubik e Rrëshen. Tregohet kujdes i pakët për edukimin e fëmijëve nga ana e familjeve. Ka mjaft fëmijë që në qytet sillen deri vonë në orët e natës dhe nuk kujdeset prindi për ta. Disa fëmijë përdorin fjalë fyese, pinë duhan pa gjë të keq, në ndonjë rast grupe të vegjlish shtrohen dhe pinë alkoool. Prishin dritat në shkollë, thyjnë xhamat me llas-



IN MEMORIAM



KËNDI I KUJTESËS

Sabiha Kasimati: Evolucioni është në natyrën e gjërave

Fatmira Nikolli.

“Më akuzuan për terroriste. Me dhunë shkohet vetëm në shkatërrim”

Gentiana Sula: Jeta e saj me zhvillime domethënëse dhe veprimtaria shkencore e prerë në mes

Më akuzuan për terroriste. U thashë: Unë kam studiuar për biologji dhe jam evolucioniste. Evolucioni është në natyrën e gjërave. Me dhunë nuk shkohet dot as në socializëm, as në demokraci; shkohet drejt shkatërrimit”. Këto kanë qenë fjalët e fundit në qeli që Sabiha Kasimati i rrëfente shoqes së vet.

Dje, në ditën e parë të vitit akademik universitar 2018-2019, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit përuroi këndin e kujtesës për Kasimatën, në Muzeun e Shkencave të Natyrës, që tashmë mban emrin e saj. Nderi i Kombit dhe themeluesja e këtij muzeu, për të nderuar kontributin e saj profesional dhe integritetin në takimin e djeshëm morën pjesë dhe vlerësuan figurën e saj, dekan i Fakultetit të Shkencave të Natyrës prof. dr. Spiro Drushku, rektori i Universitetit të Tiranës, prof. dr. Mynyr Koni, ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Lindita Nikolla dhe Uran Butka, në prani të përfaqësuesve të shumtë të botës akademike, familjarëve, studiuesve, studentëve dhe trupit diplomatik.

Me realizimin e këndit informues në hyrje të Muzeut, Autoriteti vëren se përbush një ndër detyrat e tij të informimit qytetar përmes kërkimit shkencor, në funksion të së vërtetës historike dhe përbaljes me të shkuarën. Pas një pune më shumë se njëvjeçare të institucionit, të bashkërenduar me projekte të shkencës, hedhjes dritë mbi të kaluarën dhe ridimensionimit të personaliteteve, u bë e mundur që Sabiha Kasimati t'i jepet një vend nderi në Muzeun që e ideoi, konceptoi, propozoi e

themeloi, para se të dënohej dhe ekzekutohej brutalisht, për t'u braktisur në harresë dhe jetërravjeçare. Vetë Muzeu është organizuar ashtu siç Sabiha Kasimati e ideoi në dokumentin me të cilin ia propozoi ministrit të Arsimit të asaj kohe, Ernest Koliqit.

KËNDI

Këndi i kujtesës përmban materiale që e prezantojnë Kasimatën si shkencëtare dhe personalitet kurajoz. Ai është finalizuar nga bashkëpunimi i një grupi ndërdisiplinor me historianë, biologë, arkivistë, gazetarë e kërkues shkencorë dhe një pjesë e të dhënave ekspozohen për herë të parë. Narativa e jetës dhe veprimtarisë së Sabiha Kasimatit është bazuar në dokumente, shkresa, raporte e fotografi të rralla; pas propozimit të AIDSSH më 8 mars të këtij viti, për t'i dhënë emrin e saj Muzeut të Shkencave të Natyrës, vendim i miratuar unanimisht nga Senati i Universitetit të Tiranës.

Prej vitësh, studiues të shumtë, bazuar në kërkime të shumta arkivore, përmes publikimeve të ndryshme kanë synuar ridimensionimin e figurës së saj për t'i dhënë vendin që i takon në historinë dhe shkencën shqiptare. Presidenti i Republikës e ka nderuar me medaljen “Për veprimtari patriotike” dhe në kuadrin e grupit të 22 intelektualëve të pushkatuar, si “Nderi i Kombit”. Duke i prezantuar këto studime në një institucion arsimor, Autoriteti i njeh të rinjtë dhe publikun e interesuar me personalitetin e Kasimatit dhe, përmes dokumenteve e dëshmime, ndihmon në ringritjen e emrit të



saj. Në mjediset e Muzeut dje u shfaq edhe një film dokumentar mbi jetën e Sabiha Kasimatit, i gazetarit Ferdinand Dervishi.

Kryetarja e AIDSSH-së, Gentiana Sula në fjalën e mbajtur dje tha se në kënd reflektohet me narativë të pasur, - bazuar në dokumente, foto, raportime, procesverbale apo vendime, - jeta e saj me zhvillime domethënëse dhe veprimtaria shkencore e prerë në mes, në të cilën Kasimati ka kontribute të spikatura sa i përket iktologjisë. “U desh më shumë se një vit që të rindërtohej figura e kësaj zonje të rrallë, të spikatur në secilin mje-

dis ku bënte pjesë, origjinale dhe e guximshme, e thellë dhe vizionare. Puna jonë për këtë vazhdon. Një libër i plotë me shkrime të studiuesve të fushave të ndryshme, me dokumente arkivore dhe foto të rralla pritet të dalë së shpejti. Po ashtu, një axhendë praktike, e dizenuar posaçërisht, bazuar në punën e saj shkencore dhe arritjet si studiuese do të jetë së shpejti në duart e studentëve dhe profesorëve; që Sabihaja të kujtohet përmes veprimtarisë e kontributeve konkrete, jo vetëm për mënyrën tragjike si mbylli sytë”, bëri me dije kryetarja e Autoritetit.

Sula tha se në fillim të këtij viti, Autoriteti ka hapur arkivat dhe në bashkëpunim me institucionet, kontribuon në ridimensionimin e personaliteteve të ndryshme të dijes, të përndjekur nga Sigurimi i Shtetit. Sabiha Kasimati është në dhjetëshen e parë të studiuar, shumë shpejt pjesë e një platforme interaktive në shqip dhe anglisht, me të dhëna e detaje interesante për shumë emra të njohur të shkencës dhe edukimit.

Autoriteti e ka hapur dosjen e Sabiha Kasimatit në kërkesën e familjarëve para më shumë se një viti. Më 15 shtator të 2017-ës, figura dhe personaliteti i saj u përkujtuuan në mjediset e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Po atë ditë, veç dosjes së saj të plotë, u bë e njohur edhe diploma e studiueses, e sjellë nga Universiteti i Torinos, në bashkëpunim me ambasadën italiane. Shumë aktorë u përfshinë në procesin e hedhjes dritë mbi figurën komplekse të Sabiha Kasimatit. “Duke i dhënë një vend nderi Sabiha Kasimatit në hyrje të tij, Autoriteti, në bashkëpunim me partnerët ka realizuar misionin e vet themelor, hapjen dhe nxitjen e dialogut përmes shkëmbimit të informacionit me universitetet, duke u dhënë mundësi të gjithëve të njihen me materialet e Kasimatit”, tha Sula, duke shtuar se Autoriteti ka ndërmarrë projekte serioze për hulumtimin në jetën dhe veprën e personaliteteve të anatemuar nga regjimi komunist, në përpjekje për t'i shpëlhurosor dhe sjellë në të sotmen përmes qasjes shkencore, asaj të të drejtave të njeriut dhe dëshmimeve të rezistencës.

Opinion i Ditës

Përkthimi si art, mjeshtëri dhe pasion

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... ekonomisë ndërkombëtare. Kështu, kryeveprat e letërsisë botërore janë "trashëguar" në dhjetëra gjuhë të huaja falë përkthyesve të shquar. Shprehja e njohur se "Noli e bëri Shekspirin të flasë shqip" mishëron nivelin elitë të përkthimit nolian. Në shumë takime, samite dhe procese gjyqësore ndërkombëtare përkthyesit dhe interpretët ndihmojnë dhe lehtësojnë procesin e vëzhgimit të negociatave dhe hartimit të traktateve ndërkombëtare. James Robbin, korrespondent legjendar i 'BBC'-së thotë se "përkthyesit shpesh janë njerëz të padukshëm, që shërbejnë si zbutës midis dy palëve kundërtëse, ndaj aftësinë e tyre gjuhësore mund ta krahasosh me artin".

Krahas përkthyesve të shumtë të specializuar të veprave letrare dhe artistike në çdo vend të botës, OKB-ja angazhon 300 interpretë, siç njihen përkthyesit me gojë. Kurse institucionet evropiane kanë drejtori të përgjithshme përkthimi. Vetëm BE ka 300 interpretë në 28 gjuhë, veç 2500 të tjerëve në rezervë dhe të jashtëm. Rekordin e mban Parlamenti Evropian, që aktivizon çdo ditë deri 1000 interpretë.

Kërkesat dhe cilësitë ndaj përkthyesve janë të shumta dhe të larta. Krahas kualifikimit/specializimit në shkollat përkatëse, prej tyre kërkohet etikë e lartë, zotërimi perfekt i një dhe disa gjuhëve të huaja; për të vijuar me njohjen e historisë, traditave dhe mentalitetit të vendit/organizatës për të cilat përkthen, dallimet dhe specifikat në vlerat e tyre kulturore, zakonet etj. Këto kërkesa nuk janë "luks" dhe fakultative, por të domosdoshme për një cilësi të lartë përkthimi, mundësisht pa kurrfarë "firo" dhe për të shmanjur incidente të pakëndshme gjatë përkthimit.

Shkurt, përkthyesit/interpretët nuk janë zanatçinj teknikë apo thjesht gjuhëfolës mekanikë, por komunikatorë dhe aktorë me horizont, dije dhe kulturë të gjerë në shumë fusha. Ndaj shumë personalitete, diplomatë dhe ambasadorë në botë dhe në vendin tonë kanë ardhur nga radhët e përkthyesve/interpretëve elitare.

Veç të tjerash, situatat dhe rrethanat në të cilat kryhet përkthimi, sidomos ai me gojë, me të papriturat, udhëtimet e gjata, tensioni dhe temat e shumëllojshme kërkojnë shpejtësi, saktësi, gjakftohësi, reflekshe dhe zhërvijlltësi të veçantë, zotërimin e situatave nga më të ndryshmet e pa panik, pa përgjashtuar dhe përkthimin e një fjalori banal, çka kërkon dhe rezistencë fizike dhe mendore.

Historia e përkthimit hedh



shumë dritë mbi dinamikën e diplomacisë, politikës së jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare dy dhe shumëpalëshe. Kështu, Konferenca e Paqes në Versajë, më 1919 dhe sidomos Procesi i famshëm i Nurenbergut më 1946 nuk do të ishin mundësuar pa "ushtrinë" e përkthyesve/interpretëve.

Po ashtu, samitet e mëdha historike me praninë e më të mëdhenjëve nga SHBA, BS/Rusia, Kina, Japonia, Britania e Madhe, Franca, Gjermania etj., përmblajnë me qindra shembuj pikantë mbi rolin e protagonistëve të përkthimit që kanë hyrë në librat e historisë. Botimet e tyre të mëvonshme janë pika të besueshme referimi për publikun, ekspertët dhe historianët, për të kuptuar më mirë e më thellë natyrën dhe veçoritë e takimeve dhe proceseve që shënuan kulme historike planetare.

Përvoja e lartpërmendur është pasqyruar në shumë botime shkencore dhe akademike jashtë dhe në pak brenda vendit tonë. Gjithsesi, në këtë fushë, vëzhgime të ketë punim më cilësor se libri më i ri "Arti i përkthimit gojor" i prof. dr.

Eshref Ymeri. Së bashku me "paraardhësin" e tij "Përkthimi, histori pasioni" (2015) është bërë e mundur të përmbledhet në 1.000 faqe, "ajka" e lartpërmendur e historisë së përkthimit në të gjitha zhanret. Themi kështu, sepse janë botime që rrokin të gjithë këtë tematikë aq të larmishme, por kryesorja, sepse kanë për autor një profesor, ekspert dhe mjeshtër të përkthimit, me veprimtari prej mbi 5 dekadash. Pas ndërprerjes së studimeve për gjuhën ruse në ish-B.S., ai i përfundoi ato me rezultate të shkëlqyera në Tiranë dhe në vitet '60 u emërua pedagog në katedrën e Gjuhës Ruse në atë universitet. Gjithashtu, në vitet '80 prof. dr. Eshref Ymeri ka drejtuar redaksinë e përkthimeve në Shtëpinë Botuese "8 Nëntori", duke vijuar me përvojën e gjatë dhe si përkthyes/interpret i gjuhës ruse në takime të nivelit të lartë brenda dhe jashtë vendit edhe gjatë viteve '90.

"Arti i përkthimit gojor" përfshin të gjitha zhanret e përkthimit - letrar, artistik, politik, ekonomik, diplomatik. Me të

drejtë, Abdurrahim Myftiu e konsideron atë "libër për të gjithë", për politikanët, kronistët, historianët, etj.

Ai përbën një arkivë të vërtetë dokumentare, duke pasqyruar historikun e përkthimit në vendin tonë gjatë periudhës së pavarësisë, dy luftërave botërore, monizmit dhe deri në ditët e sotme, përfshirë edhe përkthyes/intelektualë të shquar, viktima të ndjekjes dhe persekutimit. Aty i thuret homazh dhe nderim i thellë korifenjve të përkthimit tonë, Noli, Konica, Lularasi, Kuteli, Xhuvani, Pashko, Isuf Vrioni, Gjon Shllaku, Pashko Gjeçi deri të më të rinjtë e ditëve të sotme.

Po ashtu, shprehet nderim për përkthyesit tanë që kanë punuar me dekada apo që e filluan dhe e mbyllën karrierën e tyre në Radion e Jashtme, në ATSH, në Shtëpinë Botuese, etj.

Krahas stilit plot ngjyra, me një shqipe të pasur dhe të pastër, ajo që e bën librin më të veçantë, tërheqës dhe të besueshëm është numri jashtëzakonisht i madh i referencave teorike të shoqëruara me pohime dhe intervista të gjalla, me ngjarje nga më pikantet të personaliteteve emblematikë të përkthimit gojor; aty gjen legjendarin Harry Obst dhe përkthyesit e tjerë të presidentëve amerikanë, Valentin Berezhev, përkthyes i Stalinit, Hugh Lunghi i Çurçillit, Viktor Suhordjev i Hrushovit, Pavl Palazhçenko i Gorbacovit, Çarls Friman i Presidentit Nikson në vizitën e tij historike në Pekin më 1972, Kostantin Andronikov i De Gol, Charles Poëll i M. Theçer,

Zhang Weiwei, përkthyes i Ten Siao Pinit dhe shumë të tjerë. Në pohimet/kujtimet e tyre të shumta nga përkthimi në takime/samite historike nuk mungojnë asdozot/notat e humorit dhe tragizmit, për shkak të sjelljeve dhe shprehjeve të pavend ose dhe banale të ndonjë lideri botëror.

Përvoja e tyre teorike dhe praktike kanë vlerë shumë më të madhe se ligjëratat apo manualat e ndryshme akademike dhe libreske.

Ndërkohë, autori vlerëson edhe shembujt më të mirë shqiptarë të përkthimit gojor, me përvojën e treguar nga prof. dr. Hajri Shehu për gjuhën ruse, prof. Edmond Tupe për atë franceze, Ilir Ikonome për gjuhën kineze, Engjëllushe Shqarri për anglisht bashkë me shumë autorëve dhe përkthyes të tjerë shqiptarë nga të gjitha anët e botës; këta të fundit edhe në shenjë respekti janë treguar mjaft bujarë me autorin me mbresa dhe kujtime të bollshme njerëzore dhe profesionale.

Gjithsesi, pa mbetur në përshkrime dhe kujtime, jepen shumë sugjerime dhe rekomandime praktike edhe për politikanët/liderët kudo në botë, sepse krahas aspekteve pozitive, ka pasur jo pak rastet kur nënvlefësohet dhe nuk kuptohet drejt puna dhe rëndësia e përkthyesit dhe trajtimi i tij. E kundërta ndodh me politikanët e huaj, të cilët e vlerësojnë shumë më tepër, duke krijuar lehtësitë e nevojshme, shpërbllimin, kujdesin dhe respektin e shprehur për punën dhe lodhjen e tyre.

Kërkesë tjetër e drejtë për politikanët, sidomos tanë, është që të flasin thjeshtë dhe qartë me të huajt, sidomos në konferenca shtypi, pa fjali të gjata dhe me shumë ide, pa idiomi dhe shprehje popullore, që mund të krijojnë dashje pa dashje me gjithë aftësitë e interpretëve, probleme jo të vogla politike dhe keqkuptime ndërmjet vendeve.

Së fundi, fakti që parathënimin e ka shkruar prof.as.dr. Alba Frashëri e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja është ogur i mirë për vlerësimin më të mirë të përvojës së ekspertëve tanë veteranë në këtë fushë, që nuk duan t'ia dinë për kohën dhe moshën. Botime të tilla shërbejnë dhe si tekste mësimore alternative.

Sepse, siç pohon përkthyesja e talentuar Mira Meksi, vepra e prof.dr. Eshref Ymerit është edhe "një memorialistikë e mrekullueshme e udhës së gjatë e shumë të vështirë të përkthimit në Shqipëri dhe pelegrinëve të saj. Ajo është gjithashtu një trakt plot vlerë për pedagogët e përkthimit të gjuhëve të huaja të universiteteve tona dhe udhërrëfyes për studentët e këtyre degëve që mund të kenë dëshirë një ditë t'i hyjnë me pasion fushës së përkthimit".

Shkurt, përkthyesit/interpretët nuk janë zanatçinj teknikë apo thjesht gjuhëfolës mekanikë, por komunikatorë dhe aktorë me horizont, dije dhe kulturë të gjerë në shumë fusha. Ndaj shumë personalitete, diplomatë dhe ambasadorë në botë dhe në vendin tonë kanë ardhur nga radhët e përkthyesve/interpretëve elitare.

Opinion *i* Ditës

Perceptimi për krimin/ Ramës i është thyer termometri

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... e nxjerrin Shqipërinë në vend pa probleme me krimin. Rama i mëshoi fort kontradiktës mes imazhit që krijon makineria e baltës së opozitës apo mediave dhe shifrave të certifikuar nga BE, që thonë të kundërtën.

Duhet pohuar që në fillim se lojës me numra në Shqipëri i ka dalë boja me kohë.

Me statistika, tabela dhe grafikë, Edi Rama dhe Saimir Tahiri u mbushën mendjen shqiptarëve në shtator të 2015-ës, në një 'show' gjigant të titulluar "Antidroga, një histori suksesi", se vendi që i pastër nga hashashi, ndërkohë që kanabisi kishte pushuar çdo fushë të mbjellë. Madje njësoj si sot, këto të dhëna i konfirmuan edhe ish-ambasadori amerikan, Donald Lu edhe Guardia di Finanza.

Për të mos i marrë shembujt vetëm nga një krah, po statistikave iu referohej edhe Berisha kur krenohej, tribunë më tribunë, se në kulmin e krizës, vendi që i dyti në Europë pas Gjermanisë.

Statistikave iu referohej edhe Ministria e Brendshme, kur fliste për vrasjen e Selenicës, që e llogariste si një të vetme, megjithëse autori kishte bërë kërdimë mbi 8 persona.

Pra loja me statistikat, përpara se të jetë një shkencë e besueshme, është e varur krejtësisht nga vullneti i atij që i përdor ato. Dhe kur ato i marrin në dorë politikanët, përfundimi dihet.

Por pavarësisht kësaj, problemi i qeverisjes së Ramës nuk është as tek numrat, as tek krahasimet. Shqiptarëve nuk mund t'u hidhet hi syve duke bërë paralele me Romën apo Athinën. Sepse çështja e krimin të jetë në anën tona nuk është se sa vrasje kryhen në vit, sesa dyqane vidhen me forcë, apo sa vajza përdhunohen në muaj. Ai fatkeqësisht është tejet më i madh. Pyetja bëhet nëse krimi ka kapur



shtetin. Dhe në raste të tilla, kur bandat dhe pushteti bëhen një, asnjë krahasim numrash nuk ka më vlerë. Madje, në diktatura, qoftë të majta dhe qoftë të djathta, evidencat e krimin ordiner bien ndeshëm. Në Shqipërinë komuniste kishte më pak vrasje të tilla dhe ky pohim është po aq i vërtetë si për kohën e fashizmit në Itali, apo të nazistëve në Gjermani.

Pra, aksioma është e thjeshtë: sa më lart që ngjitet krimi në hierarkinë e pushtetit, aq më pak kanë hapësirë keqbërësit e vegjël ordinerë.

Kriminalizimi nga lart të bën ta fitosh realisht betejën me statistikat, por ai njëkohësisht të bën ta fitosh edhe betejën me faktet.

Sepse në një pushtet të krimi-

nalizuar, ku as policia, as prokuroria, as gjykatat nuk e bëjnë punën e tyre, krimet as nuk regjistrohen.

Ka plot fakte të kohës së qeverisjes së Rilindjes që e dëshmojnë këtë.

Rasti i Xhislielës që ende për 6 muaj komisarivate dhe askush nuk i merrte denoncimin, sepse përdhunuesi ishte djali i deputetit të PS, përpos mëkateve të tjera, e pengonte atë të ishte edhe një shifër e ftohtë në listën e statistikave të vazjavave të përdhunuara.

Rasti i fsheljes së kërkesës zyrtare të Interpolit për deputetin Mark Froku, e zbriste edhe përqindjen e të shpallurve në kërkim ndërkombëtar që ishin pjesë e Kuvendit të Shqipërisë.

Manipulimi i kryeministrit me certifikatën e pastërtisë së Elvis

Roshit, i lëvizte automatikisht edhe statistikat e kryebashkiakëve që kanë pasur më parë një dënim me burg jashtë vendit.

Kështu ndodh pra në një shtet të kriminalizuar: e para krimi i vogël ka realisht tendencën të bjerë dhe e dyta krimi real nuk merret vesh kurrë, sepse institucionet i shërbejnë politikës përpara së vërtetës.

Pikërisht për këtë, kryeministri "vuante" se njerëzit besojnë më shumë tek perceptimi, sesa tek tabelat dhe grafikët që u servir ai. Më kot ai mëtoi dhe sot t'i quante ato termometrin real të matjes së kriminalitetit. Sepse në mbretërinë ku sundon propaganda, një termometër i tillë rezulton i thyer.

"Lapsi.al"

HOROSKOPI

DASHI

Në planin financiar duhet ta verifikoni mirë buxhetin para se të investoni në një projekt për të cilin keni shpresa të mëdha. Edhe pse do dëshironit të kaloni më tepër kohë me partnerin, koha do ju mungojë plotësisht.

DEMI

Me paratë duhet më shumë maturi se kurrë. Situata do jetë shumë delikate. Me partnerin gjërat duket se po ecin mirë, por nevojitet më shumë sinqeritet nga ana juaj.

BINJAKET

Në planin financiar do keni goxha vështirësi. Menaxhohini me kujdes të ardhurat. Yjet nuk ju favorizojnë, nëse bëni një gabim të pakorrigjueshëm. Në dashuri po bëni një hap para, dy hapa mbrapa.

GAFORJA

Nëse po mendoni që të bëni një udhëtim, gjasat janë që të anulohet. Personat që nuk janë në një lidhje nuk duhet të ëndërronin më shumë sesa duhet, sepse do përballen me zhgënjime.

LUANI

Mos shpenzoni për gjëra pa vlerë, sepse mund të ndihni keq më vonë. Një debat mund të përfundojë me prishjen e një miqësie të vjetër. Mos e ktheni kokën pas, sepse në fund të ditës do të kuptoni se ajo miqësi nuk ka ekzistuar kurrë.

VIRGJERESHA

Duhet ende të bëni pak durim në planin financiar. Ditë mjaft pozitive dhe interesante kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Do ndiheni për mrekulli në krahët e partnerit tuaj dhe mund të merrni edhe vendime mbi të ardhmen.

PESHORJA

Financat duhen pasur më në vëmendje se kurrë. Nëse i lini pas dore, do të keni probleme serioze. Në dashuri do përjetoni emocione të shumëllojshme dhe do doni që ato momente të mos mbaroni kurrë.

AKREPI

Për beqarët nuk priten surpriza të mëdha gjatë kësaj dite. Gjithçka do jetë si zakonisht. Financat do të jenë disi të favorshme që të mund të kryeni investimet e planifikuara.

SHIGJETARI

Do jetë një nga ditët më të bukura në çift. Do kaloni momente pasionante dhe emocionuese me partnerin. Sa u përket parave, duhet të tregoni shumë kujdes, sepse gjërat nuk po shkojnë mirë.

BRICJAPI

Mundohuni të kaloni më tepër kohë me miqtë që të mos mendoni mbi mungesën e një partneri në jetën tuaj. Në planin financiar do e keni të nevojshme të hiqni dorë nga shpenzimet e mëdha.

UJORI

Në dashuri gjërat do ju ecin mirë sot. Me paratë bëni kujdes, sepse një investim që keni bërë vitë më parë mund të dështojë. Një analizë e thellë mbi financat duhet në këto momente.

PESHQIT

Në planin financiar do e dini mirë çfarë hapash të hidhni që situata të stabilizohet. Konfigurimi i yjeve do jetë pozitiv gjatë kësaj dite dhe ju do jeni më të qartë për atë që doni të bëni.

Futbollistët nuk zbresin në fushë, Muzaka ia komunikon vendimin trajnerit Orges Shehi

Jeton Selimi

Plas te Skënderbeu, lojtarët bojkotojnë stërvitjen

Kampionët nuk paguhen prej tre muajsh

Skënderbeu nuk po ka slon aspak çaste të mira. Pavarësisht asaj që duket, pavarësisht fasadës që drejtuesit e klubit kanë bërë çmos ta ruajnë të pacenuar, gjërat nuk po shkojnë aspak në drejtimin e duhur. Dhe nuk po flasim për çështjen tashmë të njohur të trukimeve dhe apelimit të saj në KAS-in e Lozanës. Te Skënderbeu gjërat nuk po shkojnë mirë brenda ekipit dhe kjo situatë tashmë ka shpërthyer ditën e djeshme. Lojtarët bardhekuq nuk kanë pranuar të dalin në stërvitje dhe vendimin ia kanë komunikuar trajnerit Orges Shehi, raportori "Panorama Sport". Arsyjeja? Financiare natyrisht. Kampionët kanë tre muaj pa u paguar dhe kanë vendosur që të protestojnë në këtë mënyrë.

Situata dje në qendrën stërvitore të kampionëve ka qenë e pazakontë. Histori të ngjashme kemi dëgjuar shpesh në klubet e ligave të ulëta apo edhe në klube të superiore në gjysmën e dytë të renditjes, por jo te Skënderbeu. Të paktën që kur klubi u formatua 8 vjet më parë për t'u bërë dominuesi i futbollit shqiptar. Por pavarësisht anës së jashtme, te kampionët gjërat nuk po ecin mirë dhe gjithçka ka lidhje me dënimin e KAS-it që ceni ndjeshëm besueshmërinë e Skënderbeut në Europë dhe një pjesë e lojtarëve preferuan të largohen në klube të tjera në kontinent apo edhe në superligë. Menjëherë pas kësaj kanë ardhur dhe reagimet e para, siç ishte dhe rasti i Sabein Lilajt, mesfushori bardhekuq që u transferua te Qabala në verë dhe i kërkoi presidentit Takaj 126 mijë eurot e papaguara në dy vitet e fundit, një shumë e frikshme kjo dhe po flasim për një nga lojtarët më me reputacion në kampin korçar, që vendosi ta bëjë publike situatën e tij menjëherë sapo mbylli aventurën e tij te Skënderbeu. Por dje situata ishte vërtet dramatike. Gjergj Muzaka ka shkuar të takojë në fushën e blertë trajnerin Orges Shehi, që priste si gjithnjë të niste punën për të përgatitur përballjen e fundit të fazës së parë të kampionatit, ndeshjen kundër Kamzës. Por skuadra nuk ka preferuar të zbrësë në fushë pasi prej ditësh priste një përgjigje nga presidenti Takaj, përgjigje e cila nuk ka ardhur dhe ka shtyrë lojtarët që të marrin vendimin e bojkotit. Sikundër përflitet, rrogat e papaguara janë të rrepta ende nuk ka një qëndrim zyrtar të klubit bardhekuq në lidhje me ngjarjen në fjalë, që padyshim ka tronditur tifozërinë korçare, e cila dëshiron t'i shohë sërish në majë të klasifikimit idhujt e saj.



Skënderbeu gjatë një stërvitjeje

SUPERLIGA		
JAVA E 9-TË		
Të shtunën		
Kastrioti - Kukësi	14:00	
Laçi - Teuta	14:00	
Të dielën		
Skënderbeu - Kamza	14:00	
Partizani - Luftëtari	17:00	
Të hënën		
Flamurtari - Tirana	18:00	
Renditja		
Skuadra	N	F
Partizani	8	19
Skënderbeu	8	17
Laçi	8	16
Kukësi	8	13
Flamurtari	8	11
Teuta	8	11
Tirana	8	8
Kamza	8	7
Luftëtari	8	6
Kastrioti	8	4

SHKURT

Laçi-Teuta do të luhet në "Elbasan Arena"

Laçi do t'u bashkohet për disa javë Kukësit dhe Kastriotit, dy skuadrave që i luajnë ndeshjet si pritës në fushë asnjanshë. Në fushën e stadiumit të Laçit është bërë mbjellja e barit dhe duhen disa javë që tapeti të jetë gati. Kështu, ndeshjen e radhës me Teutën, Laçi do të luajë në stadiumin "Elbasan Arena". E konfirmim këtë fakt klubi durrsak me një njoftim në faqen e vet zyrtare në "Facebook", ku bën të ditur datën, vendin dhe orarin e ndeshjes me kurbinasit. Laçi-Teuta do të luhet ditën e shtunë, në orën 14:00, nëse deri atëherë nuk do të ketë ndonjë ndryshim nga ana e FSHF-së.

Partizani garanton: Alban Hoxha rikthehet shpejt në portë

Alban Hoxha la disa ditë më parë grumbullimin e Kombëtares për shkak të një dëmtimi dhe më pas u fol se "gardiani" i ekipit të kuq rrezikonte sezonin. Por këto zëra janë hedhur poshtë nga klubi i Partizanit, që ka sqaruar situatën për portierin dhe kapitenin e ekipit. Bëhet fjalë për një dëmtim të ligamentit të gradës së parë. "Kapiteni i kuq, i cili u detyrua të mos udhëtonte me ekipin përfaqësues drejt Izraelit si pasojë e një dëmtimi, menjëherë i është nënshtruar një kontrolli të specializuar mjekësor nën mbikëqyrjen edhe të stafit mjekësor të skuadrës. Ndonëse flitej për një dëmtim serioz, fatmirësisht analizat e rezonancës kanë konstatuar një dëmtim të ligamentit të gradës së parë. Stafit mjekësor garanton se kapiteni Hoxha do t'i nënshtrohet për disa ditë një faze rikuperimi, për të qenë sa më shpejtë i gatshëm në fushë".

Ish-presidenti në sulm kundër trajnerit të Kombëtares

Nishani: Panuçi nuk mund të na japë leksione edukate

Pak ditë javë më parë, trajneri i kuqezinjve, Kristian Panuçi ka paditur në gjykatë ish-Presidentin e Republikës, Bujar Nishani, për prishje të imazhit dhe fyerje, duke kërkuar prej tij 100 mijë euro dëmshpërblim moral. Fillimisht, padia e Panuçit ishte me të meta dhe gjykata e ktheu mbapsht duke mos nisur procesin deri në plotësimin e tyre. Por, gjyqësori e ka marrë në konsideratë padinë e trajnerit italian, të rregullt tashmë dhe pritet në fund të gjyqimit të zbardhet vendimi. Në një intervistë të dhënë për "Intr", Nishani edhe njëherë i është rikthyer debatit në distancë me Panuçin dhe ka theksuar se: "Unë e ndjek Kombëtaren. Shikoni, zotëria që ka një përgjegjësi, padyshim është trajneri. Por, përgjegjësia ka edhe hierarki dhe shpërndahet. Unë nuk kam asnjë polemikë me zotërinë. Kam shprehur në një moment të caktuar, për shkak të disa rrethanave të caktuara, një opinion timin, në rrjetin tim personal social me miqtë e mi. Zotëria është ndier i ofenduar; i është drejtuar gjykatës", - tha fillimisht ish-Presidenti i Republikës. Lidhur me procesin gjyqësor, Nishani shtoi se: "Unë do të ndjek procesin gjyqësor, sepse respektoj shtetin. Kam një merak, që nuk mund ta pranoj dhe përtyp. Personi në fjalë është njeriu më i papërshtatshëm për të na dhënë leksione edukate. Në një intervistë,




menjëherë pas ndeshjes me Kosovën, ai ka përdorur një fjalë përpara kamerave, përpara familjeve shqiptare; ka përdorur një fjalor rrugaçerie. Ai nuk është i pranueshëm në kodin shqiptar, por as në çdo kod të një shoqërie etike". "Ky person, që bilbilos me këtë fjalor të papranueshëm, tenton të na japë edhe leksione edukate

dhe qytetarie. Ky për mua është i papranueshëm, pjesa tjetër e çështjes do të shqyrtohet nga gjykata. Unë mendoj që nuk është faji i tij. Mendoj se "lepuri fle tjetër kund", por ferra ku fle lepuri duhet kositar. Ajo mbetet për t'u parë në ditët që vijnë", - tha ish-Presidenti i Republikës, Bujar Nishani.

ISH-PRESIDENTI

"Unë e ndjek Kombëtaren. Shikoni, zotëria që ka një përgjegjësi, padyshim është trajneri. Por, përgjegjësia ka edhe hierarki dhe shpërndahet. Unë nuk kam asnjë polemikë me zotërinë".

Fjalëkryqi (1)




- HORIZONTAL
2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomie e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenjta.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstreme në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.

- 34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonom.
40. Në krye yë evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremit në litar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

- VERTIKAL
1. Novarro qe qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat qe prodhohen.
10. Eshhtë ai qe gënjën për t'u bërë i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga filibusterët.
16. Një përslatje.
17. Agjenci Informative Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon qe qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL
1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum qe qe pianist.
15. Një qe lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipo
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
34. Neill i Jurassic park.




- 35. E bukura e belle epoque.
37. Qe mbreti i elfëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rockstar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga mabusit i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor

- VERTIKAL
2. Ishin grekët në trojë
3. Ishin palate të beut
4. Goodéin, ndihmësi i Nero Wolfe
5. Pak sinqeritet
6. Personazhet e Charles Schulz.
7. Kompozoi Mefistofele
8. Në radhë të parë.
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos qe qe pilot i Formula 1
15. Ekstremit në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërore
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lemper, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

Sudoku grid with numbers 1-9 in some cells and empty cells for filling.

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

Solved 9x9 Sudoku grid with numbers 1-9.

Argëtim filozofik

Mos e duaj gjumin shumë; hap sytë që të mos mbetesh i uritur.

Toka mund t'i ushqejë njerëzit fare mirë; vetëm pse shumica e pasurisë shpenzohet pa vend, e shumica e njerëzve mbeten të uritur.

Për t'ia nënshtruar botën mirësisë, duhet luftuar kundër ligësisë.

Botimi i pozitës varet nga të tjerët. A nuk është marrëzi të lësh atë që ke në duart tua dhe t'u drejtohesh të tjerëve.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME Përgjigja e numrit të djeshëm

17x17 grid for cryptogram puzzle

17x17 grid with the solution for the cryptogram: STARLETIKETA, ARMIKSTOLITE, LIOROMINAT, LOCABARETLA, ABATERITEAR, TRIMERITANE, ARTUROUIMATT, ARSENTEAIA, ADATMETRIAC, PAKTPIRATERI, KUALITETI EP, LECEPINATA

Vertical crossword puzzle with words like FERMANI, AKSIL, ROHINEP, etc.

Argëtim filozofik

Thënie të mënçura

- Më parë se për pasurinë, mjeshtërinë dhe tregtinë e një bashkësie (njerëzore), duhet menduar për edukimin e saj, sepse edukata e mirë është baza e bashkësisë njerëzore.
Njeriu merret me dituri dhe me shkencë gjatë gjithë jetës
së tij. Në fëmijëri i mëson ato, në rini i vë në zbatim e në pleqëri mëson të tjerët.
Zemra e njeriut të përsosur është gjithmonë e pezmatuar, por fytyra e tij është kurdoherë e gëzuar.

